



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 372 Akti

Nr. 474 Vendimi
Tiranë, më 12.11.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Brunilda Bekteshi	Kryesuese
Firdes Shuli	Relatore
Suela Zhegu	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Orjanda Liçi, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, në datat 9.11.2021 dhe 12.11.2021, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Ervin Trash**i, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Firdes Shuli, mori në shqyrtim çdo provë dhe dokument të vënë në dispozicion nga organet kompetente ligjore, shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Ervin Trash, i cili në seancën dëgjimore publike të datës 9.11.2021 kërkoi riçeljen e hetimit edhe për aspektin e vlerësimit profesional dhe konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Ervin Trashi është subjekt i rivlerësimit për shkak të detyrës të tij si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016). Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit” në datën 16.12.2019 është zhvilluar shorti, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Ervin Trashi do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Brunilda Bekteshi, Firdes Shuli dhe Suela Zhegu. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Firdes Shuli.

2. Për këtë subjekt rivlerësimi u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31-33 të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; dhe Këshilli i Lartë i Gjyqësor (në vijim KLGJ) sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.

3. Me vendimin nr. 1, datë 24.12.2019, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Ervin Trashi, si dhe të caktojë kryesuesin e trupit gjykues, komisioneren Brunilda Bekteshi. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit. Nëpërmjet postës elektronike, në datën 29.1.2020, subjekti deklaroi mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

4. Me vendimin nr. 2, datë 20.10.2021, trupi gjykues vendosi mbylljen e hetimit administrativ bazuar vetëm për kriterin e pasurisë dhe të figurës, duke vlerësuar se provat e administruara për këto kritere deri në këtë fazë të procesit të rivlerësimit kishin nivelin e provueshmërisë, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016.

5. Në datën 21.10.2021, përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit administrativ për kriterin e pasurisë dhe të figurës; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar të kundërtën e konstatimeve të Komisionit, jo më vonë se data 1.11.2021; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative.

6. Në datën 28.10.2021 subjekti paraqiti një kërkesë përmes postës elektronike, nëpërmjet së cilës kërkoi zgjatjen e afatit të paraqitjes së provave dhe prapësimeve ndaj rezultateve të hetimit për shkak të pamundësisë për përgatitjen e parashtrimeve, pritjen e një aktekspertimi kontabël dhe përgatitjen e mbrojtjes nga ana e tij.

7. Komisioni vlerësoi të pranojë kërkesën dhe me vendimin nr. 3, datë 28.10.2021, vendosi të shtyjë afatin për dërgimin e parashtrimeve deri në datën 5.11.2021, brenda orës 14:00. Në datën 29.10.2021, përmes postës elektronike, Komisioni informoi subjektin për pranimin e kërkesës.

8. Në datën 5.11.2021, përmes postës elektronike, subjekti dërgoi parashtrimet dhe provat mbi rezultatet e hetimit administrativ, kërkesë për marrje provash shkresore dhe dëshmitarë, si dhe kërkoi riçeljen e hetimit administrativ edhe për kriterin e aftësive profesionale.

9. Me vendimin nr. 3, datë 5.11.2021, Komisioni, pasi shqyrtoi parashtrimet dhe dokumentet e vëna në dispozicion nga subjekti, vendosi të rrëzojë kërkesën për riçeljen e hetimit administrativ për kriterin e aftësive profesionale dhe marrjen e provave të reja, si dhe të caktojë seancën dëgjimore për në datën 9.11.2021, ora 13:30. Në datën 5.11.2021 subjektit iu njoftua vendimi për caktimin e seancës dëgjimore.

10. Në datën 5.11.2021 subjektit iu njoftua vendimi për caktimin e seancës dëgjimore, si dhe u informua se kërkesa për riçelje hetimi nuk është pranuar, duke iu bërë me dije se vetëm pas marrjes në shqyrtim të të gjitha parashtrimeve dhe provave, së bashku me ato që do të paraqiteshin në vijim edhe në seancën dëgjimore, trupi gjykues do të vlerësojë dhe do të vendosë në lidhje me provueshmërinë e tyre në kundërshtim të barrës së provës, si dhe riçeljen e hetimit administrativ edhe për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale.

11. Në datën 9.11.2021 u zhvillua seanca dëgjimore, në të cilën subjekti i rivlerësimit ishte i pranishëm dhe, në përfundim kërkoi riçeljen e hetimit administrativ edhe për kriterin e vlerësimit profesional. Në këtë seancë subjektit iu komunikua data e seancës së radhës, 12.11.2021, në orën 9:45.

12. Në datën 12.11.2021, në orën 9:45, u zhvillua seanca për shpalljen e vendimit të Komisionit, ku subjekti nuk ishte prezent. Në këtë seancë nga ana e Komisionit u komunikua që kërkesa e subjektit për riçelje të hetimit administrativ edhe për kriterin e aftësive profesionale nuk ishte pranuar, pasi subjekti nuk kishte kundërshtuar tërësisht barrën e provës për dy kriteret e tjera.

13. Pas shpalljes së vendimit, nga ana e relatores së çështjes u aksesua *e-mali* zyrtar dhe u konstatua se në orën 8:35, të datës 12.11.2021, subjekti kishte njoftuar për pamundësinë objektive për të qenë prezent në seancën e datës 12.22.2021, duke paraqitur një raport mjekësor, me afat një ditë paaftësie në punë dhe kishte kërkuar shtyrjen e afatit për shpalljen e vendimit.

II. PARIME TË PËRGJITHSHME TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

14. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

15. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

16. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin në

lidhje me kontrollin e figurës. Sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

17. Referuar vendimit nr. 2/201721, të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

III. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI

18. Në zbatim të nenit 31/1 të ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit Ervin Trashi ka dorëzuar në ILDKPKI deklaratën e pasurisë në datën 26.1.2017, pra, në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi. Gjithashtu, në referencë të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, vërehet se subjekti i rivlerësimit Ervin Trashi është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2007, me nr. indeksi *** dhe ka dorëzuar rregullisht deklaratat e interesave private vjetore (në vijim DPV).

19. ILDKPKI-ja ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për subjektin Ervin Trashi ka konstatuar se: (i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin financiar të pasurive; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; si dhe (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

20. Në përmbushje të funksioneve të tij kushtetuese, sipas pikës 1, të nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka kryer një proces të plotë hetimi administrativ për figurën dhe pasuritë e subjektit të rivlerësimit Ervin Trashi, si dhe të personave të lidhur me të, sipas dispozitave ligjore të kreut VII të ligjit nr. 84/2016, bazuar në: (i) deklarinimet e subjektit në ILDKPKI; (ii) provat shkresore të administruara nga ky institucion dhe raporti i dorëzuar në Komision; (iii) çdo dokument ligjor që përbën mjet prove ligjore të kërkuar nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit, sipas nenit 49 të ligjit nr. 84/2016; si dhe (iv) komunikimet me subjektin sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016 dhe dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative.

21. Hetimi administrativ në lidhje me rivlerësimin e pasurisë konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarinimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive; (iv) evidentimin e deklarinimeve të rreme; si dhe (v) nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, me qëllim verifikimin e deklarinimeve të pamjaftueshme në lidhje me kriterin pasuror, sipas parashikimit të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar pasurinë:

22. *Apartament banimi me sipërfaqe 56 m², ndodhur në O., Vlorë, nr. pasurie ***, shkalla **, kati **. Kontrata e blerjes nr. ***, datë 27.9.2012, redaktuar para noteres M. Gj., Vlorë. Vlera: 24.000 (njëzet e katër mijë) euro. Pjesa takuese: 100 %. Nuk është deklaruar burimi i krijimit.*

ILDKPKI-ja ka konstatuar mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për burimin financiar në vitin 2011, në shumën 1.800.000 lekë nga shtetasi G. T. (vëllai i subjektit). Rezulton se kontrata e huamarrjes, datë 25.1.2011, në shumën 1.800.000 lekë, me afat 10-vjeçar dhe pa interes, nuk është noteriale dhe kalimi nuk është kryer nëpërmjet sistemit bankar.

Hetimi i kryer nga Komisioni për këtë pasuri

23. Sa i takon origjinës se kësaj pasurie dhe mënyres së krijimit, nga aktet¹ në dosje rezultoi se:

- Sipas kontratës nr. ***, datë 4.9.2008, subjekti, në cilësinë e porositësit, ka prenotuar te sipërmarrësi “O. K.” sh.p.k. apartament me sipërfaqe totale 64.1 m² (1+1), me sipërfaqe ndërtimi 55.7 m² + 8.4 m² sipërfaqe e përbashkët, apartamentin “***”, objekti -2, në katin e pestë (kati i katërt banimi), me çmim 27.000 euro.
- Sipas vërtetimit, nga dokumentet hipotekore lëshuar në datën 11.7.2011, në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 11.7.2011, figuron e regjistruar në pronësi të shoqërisë “O. K.” sh.p.k. pasuria nr. ***.
- Sipas kontratës së shitjes së pasurisë nr. ***, datë 27.9.2012, z. Ervin Trashi ka blerë nga shitësi “O. K.” sh.p.k. pasurinë nr. ***.
- Sipas vërtetimit nga dokumentet hipotekore lëshuar në datën 3.10.2012 dhe nga verifikimi në sistemin *online* të ASHK-së, vërtetohet regjistrimi i pasurisë nr. ***, në pronësi të z. Ervin Trashi.
- FSHU-ja dhe UK-të Vlorë, kanë informuar në lidhje me furnizimin me ujë dhe energji elektrike të pasurisë me abonent Ervin Trashi².

24. Në lidhje me çmimin e shitjes dhe mënyrën e likuidimit, rezultoi se:

- Në kontratën e porosisë nr. ***, datë 4.9.2008, është parashikuar se çmimi 27.000 euro (konvertuar në 3.200.000 lekë) do të likuidohet në këtë mënyrë: 24.000 euro në momentin e miratimit të kredisë që pala blerëse e ardhshme është duke aplikuar. Kjo kontratë nuk shprehet për likuidimin e pjesës së mbetur prej 3.000 euro.
- Në DPV-në për vitin 2008 subjekti ka deklaruar *apartament me sip. 55.7 m², me adresë O., Vlorë, blerë me kontratën nr. ***, datë 4.9.2009, në vlerën 27.000 euro. 100%*. Nuk ka deklaruar burimin e krijimit.
- Në kontratën e shitjes nr. ***, datë 27.9.2012, parashikohet i njëjti çmim prej 27.000 euro, me sqarimin se blerësi e ka paguar të gjithë çmimin jashtë zyrës noteriale, në këtë mënyrë: 24.000 euro paguar në datën 3.10.2008, me kalim bankar dhe 3.000 euro janë punime të kryera nga vetë klienti.
- Në DPV-në për vitin 2012 subjekti ka deklaruar *apartament banimi me sip. 56.18 m², ndodhur në O., Vlorë, me nr. pasurie ***, në vlerën 24.000 euro*, pa deklaruar burimin e krijimit.
- Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar vlerën e pasurisë prej 24.000 euro, pa deklaruar burimin e krijimit.

25. Siç vërehet, evidentohet një paqartësi në lidhje me çmimin e shitjes së pasurisë, për shkak të mospërputhjes me vlerën e shënuar në të dyja kontratat, në DPV-në për vitin 2008, ku çmimi është 27.000 euro, me DPV-në për vitin 2012 dhe atë *Vetting*, ku vlera e pasurisë është deklaruar 24.000 euro. I pyetur gjatë procesit të rivlerësimit për këto mospërputhje, në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti ka dhënë sqarime të detajuara në lidhje me diferencën prej 3.000 euro, duke lënë të kuptohet që edhe pse çmimi fillestar i pasurisë ka qenë 27.000 euro, në

¹Shihni aktet në aneksin nr. 4/2 dhe nr. 28, në dosjen e ILDKPKI-së.

²Shihni shkresën nr. *** prot., datë 14.5.2020, dhe shkresën nr. *** prot., datë 21.9.2021, të FSHU-së, në dosjen e Komisionit dhe shkresën nr. *** prot., datë 15.9.2021 të UK-të, Vlorë në dosjen e Komisionit

momentin e nënshkrimit të kontratës përfundimtare pala shitëse “O. K.” sh.p.k. nuk kishte përmbushur të gjitha kërkesat e rëna dakord midis palëve, duke specifikuar të metat e konstatuara, të cilat deklarohen se i ka rregulluar vetë. Në këtë mënyrë, sipas subjektit, çmimi i shitjes është 24.000 euro. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se nuk ka kryer punime të mëtejshme në apartament.

26. Në analizën financiare të kryer në përfundim të hetimit administrativ, si shpenzim për blerjen e pasurisë është konsideruar vlera 27.000 euro, nga të cilat 24.000 euro janë paguar në rrugë bankare dhe shuma 3.000 euro është përfshirë si shpenzim, e ndarë në mënyrë të barabartë për vitet 2010, 2011 dhe 2012³, nisur nga faktet: (i) në të dyja kontratat çmimi i shitjes është parashikuar 27.000 euro; (ii) në kontratën e shitjes është specifikuar se *blerësi e ka paguar të gjithë çmimin jashtë zyrës noteriale, 24.000 euro paguar në datën 3.10.2008, me kalim bankar dhe 3.000 euro janë punime të kryera nga vetë klienti*; si dhe (iii) gjatë hetimit administrativ subjekti ka pranuar rregullimin e të metave të sendit prej tij.

27. Sa i takon trajtimin të mundshëm preferencial në blerjen e kësaj pasurie, sipas udhëzimit nr. 1, datë 20.8.2008, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB për vitin 2008”, për zonën e O. ku ndodhet apartamenti, çmimi i referencës për vitin 2008 është 49.000 lekë/m². Referuar këtij çmimi, apartamenti i blerë do të kushtonte 62.63 m² x 49.000 m² = 3.068.870 lekë, ndërkohë që subjekti ka shpenzuar për të shumën 27.000 euro ose 3.373.000⁵ lekë. Vërehet se subjekti e ka blerë pasurinë më shtrenjtë se çmimi i referencës, çka nënkupton se ai nuk është trajtuar në mënyrë preferenciale. Veç kësaj, nuk u vërtetua që subjekti të jetë në kushtet e konfliktit të interesit⁶, pasi gjykatat e rrethit Gjirokastër dhe Vlorë, ku subjekti ka ushtruar detyrën, nuk kanë konfirmuar gjykime prej tij të çështjeve me palë shoqërinë “O. K.” sh.p.k., apo administratorin e saj z. R. I..

28. Sa i takon burimin të krijimit të pasurisë, konstatohet se subjekti nuk ka deklaruar sipas ligjit burimin e krijimit në rubrikën përkatëse të formularëve të deklarimit në DPV-në për vitin 2008 kur është lidhur kontrata e porosisë, në DPV-në për vitin 2012 kur është lidhur kontrata e shitjes, si dhe në deklaratën *Vetting*. Por, në rubrikën “Detyrimet financiare” të DPV-së për vitin 2008, subjekti ka deklaruar një kredi, si dhe faktin që ka shërbyer si burim për blerjen e pasurisë, ndërsa në seksionin e detyrimeve të deklaratës *Vetting* ka deklaruar: “*Kontratë kredie bankare nr. ***, datë 29.9.2008, në shumën 20.000 euro. Qëllimi: për blerje apartamenti në O., Vlorë*”. Ndërsa në deklaratën *Vetting*, në rubrikën e detyrimeve, subjekti ka deklaruar: “*Kontratë huaje nr. ***, datë 25.1.2011, shuma e detyrimit 1.800.000 (një milion e tetëqind mijë) lekë. Kjo shumë jepet me qëllim shlyerjen e kontratës së kredisë bankare nr. ***, datë 29.9.2008. Afati maksimal i përmbushjes së detyrimit për 10 vjet, pa interesa. Shlyer plotësisht detyrimi në dhjetor të vitit 2015*”.

Analizë e kredisë së marrë në shumën 20.000 euro dhe investimit në shumën 4.000 euro nga subjekti dhe destinacioni i përdorimit të tyre

³Për shkak të mungesës së ndonjë shpjegimi nga subjekti, është supozuar që apartamenti është dorëzuar në fund të vitit 2009, duke marrë si *indicie* deklaratën e mobilierit për punimet e mobilieve gjatë viteve 2009-2010, dhe duke konsideruar që subjekti ka filluar të bëjë riparime të ambientit të brendshëm nga viti 2010 deri në vitin 2012, kur apartamenti është blerë dhe është hipotekuar.

⁴Kjo sipërfaqe përbëhet nga 56.18 m² sipërfaqe e brendshme dhe 6.45 m² sipërfaqe ballkoni.

⁵Për shumën 24.000 euro është përdorur kursi i këmbimit i datës 31.12.2008, 1 euro = 123.18 lekë, ndërsa për shpenzimin prej 3.000 euro, i cili është ndarë në pjesë të barabarta nga 1.000 euro për vitet 2010 - 2012, është përdorur kursi i datës 31 dhjetor i viteve përkatëse.

⁶Shihni shkresë nr. *** prot., datë 13.9.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastër, në dosjen e Komisionit.

29. Nga aktet shkresore të administruara⁷ u verifikua se, sipas kontratës së kredisë nr. ***, datë 9.9.2008 me palë kredidhënëse Banka Kombëtare e Greqisë dhe kredimarrës Ervin Trashi, si dhe dorëzanës shtetasit G. dhe N. T. (xhaxhai i subjektit dhe bashkëshortja), subjekti ka marrë një kredi në shumën 20.000 euro, me qëllim blerje/rikonstruksion apartamenti në O., Vlorë, ku pjesëmarrja e kredimarrësit në këtë investim është në shumën 4.000 euro. Sipas kësaj kontrate, dorëzanësit kanë vënë si garanci hipotekore⁸ pasurinë me nr. ***, në Lushnjë.

30. Me qëllim evidentimin e ndonjë lidhjeje të subjektit në pasurinë e vënë si garanci hipotekore, si dhe kontributit të tij të mundshëm mbi këtë pasuri, me kërkesë të Komisionit, subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka paraqitur disa dokumente shkresore⁹ që vërtetojnë pronësinë, origjinën dhe mënyrën e fitimit të pronësisë të vënë si garanci hipotekore për marrjen e kredisë nga xhaxhai G. T. dhe bashkëshortja, nga verifikimi i të cilave nuk ka dyshime për lidhje të subjektit me këtë pasuri. Sa i takon konfliktit të interesit dhe përfshirjes në veprimtari kriminale të shtetasve G. dhe N. T., gjykatat e rrethit Gjirokastrë dhe Vlorë, ku subjekti ka ushtruar detyrën, nuk konfirmuan procese gjyqësore apo vendime të dhëna prej tij me palë G. dhe N. T.. Po kështu, pas kërkesës së Komisionit, SPAK-u nuk ka konfirmuar procedime penale të regjistruara në emër të tyre¹⁰.

31. Subjekti ka kryer deklarime të sakta në lidhje me detyrimin financiar për shkak të marrjes së kredisë, si vijon: (i) në DPV-në për vitin 2008, në rubrikën “Detyrimet financiare”, ka deklaruar këtë kredi; (ii) në DPV-në për vitin 2009 ka deklaruar shumën e shlyer prej 2.112 euro dhe detyrimin e mbetur prej 28.746 euro; (iii) në DPV-në për vitin 2010 ka deklaruar shumën e shlyer prej 5.300 euro dhe detyrimin e mbetur prej 15.000 euro; (iv) në DPV-në për vitin 2011 ka deklaruar se e ka shlyer plotësisht kredinë, në shumën 15.575 euro, në datën 28.1.2011.

32. Destinacioni i kredisë prej 20.000 euro, si dhe investimi i subjektit në shumën 4.000 euro, për blerjen e pasurisë, objekt shqyrtimi, sipas parashikimit në kontratën e kredisë, u vërtetua si vijon: (i) në datën 1.10.2008 subjekti ka kryer depozitim *cash* në shumën 4.000 euro, në llogarinë e tij nr. ***, pranë Bankës Kombëtare të Greqisë (sot ABI Bank). Në datën 2.10.2008 kjo shumë është transferuar nga llogaria e subjektit në një llogari të palës shitëse; (ii) në datën 2.10.2008 është disbursuar kredia në shumën 20.000 euro në llogarinë e subjektit dhe në të njëjtën datë kjo shumë është transferuar nga llogaria e subjektit në llogarinë e shitësit, konfirmuar me shkresën nr. *** prot., datë 29.9.2021, të ABI Bank.

33. Në lidhje me burimin e të ardhurave për investimin prej 4.000 euro, u pyet subjekti, i cili, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka deklaruar: *“Sqaroj se shuma prej 400.000 lekësh të*

⁷Shihni aktet në aneksin nr. 4/4 dhe nr. 28 në dosjen e ILDKPKI-së, shkresën nr. *** port., datë 9.9.2021, të ABI Bank, në dosjen e Komisionit.

⁸Shihni shkresën nr. *** prot., datë 9.9.2021, të ABI Bank, kontratë hipotekimi të pasurisë nr. ***, së bashku me dokumentet e pronësisë, në dosjen e Komisionit.

⁹Shihni certifikatën për vërtetim pronësie, lëshuar në datën 1.9.2008, nga ZVRPP-ja Lushnjë, në pronësi të shtetasit G. T.; kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 7.2.2000, me shitës S. I. – blerës G. T., nga ku rezulton se është blerë në çmimin 2.400.000 lekë; librezën e punës të shtetasës N. T., ku rezulton në marrëdhënie pune për periudhën 1974 – 2007; librezën e punës të shtetasit G. T., lëshuar me datë, ku rezulton në marrëdhënie pune për periudhën 1970 – 2007; vërtetimin nga Bashkia Lushnjë për të ardhura e shtetasit G. T. si kujdestar i znj. N. T. për periudhën qershor 2009 – mars 2013; vërtetimin për bazën e vlerësueshme të DRSSH-së Fier për periudhën 6.2007 – 3.2013; vërtetimin nr. *** prot., datë 12.2.2018, nga DRSSH-ja Fier, për vjetërsi në punë për periudhën 15.3.1970 – 15.2.1992; si dhe vërtetimin nr. *** prot., datë 15.9.2021, nga ISSH-ja për pension invaliditeti të përhershëm të shtetasës N. T..

¹⁰Shihni shkresën nr. *** prot., datë 13.9.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë; shkresën nr. *** port., datë 17.9.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe shkresën nr. *** prot., datë 21.9.2021, të SPAK-ut, në dosjen e Komisionit.

deklaruar në vitin 2007 në deklaratën para fillimit të detyrës¹¹, është përdorur në vitin 2008 me qëllim plotësimin e shumës 24.000 euro me të cilin është porositur apartamenti në O.”.

Nga verifikimi i DPDFD-së, dorëzuar në tetor të vitit 2007, subjekti ka deklaruar *cash* 400.000 lekë, por pa deklaruar burimin. Ndërsa, nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore ka rezultuar se: (i) në DPV/2007 subjekti nuk ka kryer deklarime në lidhje me gjendjen *cash*; dhe (ii) në DPV/2008 subjekti nuk ka deklaruar pakësim të likuiditeteve *cash*, pra nuk ka deklaruar që e ka përdorur gjendjen *cash* të mbartur që nga periudha para fillimit të detyrës me qëllim pagesën e këstit prej 4.000 euro për blerjen e apartamentit. Për këtë arsye, shuma *cash* prej 400.000 lekësh, e deklaruar në DPDFD, nuk është konsideruar si burim për krijimin e shumës 4.000 euro, të depozituar në NBG/ABI Bank në datën 1.10.2008, duke u konsideruar si e shpenzuar brenda vitit 2007.

34. Komisioni ka kryer analizën financiare për të verifikuar mundësinë e subjektit për të krijuar shumën 4.000 euro më 1.10.2008, nga e cila duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për shkak të një balance negative prej 1.436.724 lekësh, pasqyruar në tabelën si vijon:

Përshkrimi	Datë 1.10.2008
Pasuri	2 009 136
Shtëpi banimi në Lushnjë	1 515 770
Depozitë tek ABI Bank	492 730
<i>Ndryshim likuiditetesh</i>	635
Total likuiditete	1 007
Të ardhura	798 076
Të ardhura nga pagat, subjekti	598 076
Nga shitja e automjetit tip “Nisan Primera”, me targa ***	200 000
Shpenzime	225 665
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	102 465
Shpenzime transporti	123 200
Mundësia për kursime	-1 436 724

Në këtë analizë është përfshirë edhe vlera e investimit të kryer për ndërtimin e katit të 3-të të banesës së prindërve, kat i cili është konstatuar të jetë ndërtuar pas datës 14.4.2007 (trajtuar në paragrafin 63 e në vijim). Gjithashtu, janë përfshirë si të ardhura të ligjshme edhe kursimet e akumuluar të prindërve të subjektit nga data 5.10.2007 deri në fund të vitit 2008¹².

Në lidhje me shlyerjen e kredisë prej 20.000 euro

35. Nga të dhënat bankare është konstatuar se në datën 28.1.2011, në llogarinë e kredisë në Bankën Kombëtare të Greqisë (sot ABI Bank), subjekti ka depozituar *cash* shumën 15.575 euro, e cila ka shërbyer për shlyerjen e parakohshme të kredisë, në të njëjtën datë. Si burim për shumën e depozituar ka shërbyer huaja në shumën 1.800.000 lekë, të cilën subjekti e ka marrë nga vëllai i tij G. T. në vitin 2011, me afat 10-vjeçar, sipas kontratës së huas (jo noteriale) të datës 25.1.2011¹³, e cila konfirmon se subjekti E. T. ka marrë nga shtetasi G. T. hua pa interes

¹¹Ka parasysh gjendjen *cash* të deklaruar në DPDFD.

¹²Prindërit e subjektit janë analizuar bazuar në metodologjinë kumulative, pasi nuk janë subjekte deklarues, duke filluar nga data e emërimit të detyrës të subjektit. Para kësaj date ka rezultuar se prindërit nuk kanë pasur kursime të akumuluar, për shkak të ndërtimit të 2 kateve të banesës, deri më 14.4.2007.

¹³Shihni kontratën e huas në aneksin nr. 4.8, në dosjen e ILDKPKI-së.

në shumën 1.800.000 lekë, me qëllim shlyerjen kredisë së marrë nga z. Ervin Trashi nga NBG. Kjo kontratë nuk shprehet mbi mënyrën e kalimit të shumës 1.800.000 lekë nga huadhënësi tek huamarrësi. I pyetur mbi mënyrën e dhënies së huas dhe likuidimin e saj, në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti ka deklaruar se për shkak të marrëdhënieve të posaçme midis vëllezërve huaja është dhënë në *cash*. Sipas subjektit, huaja është shlyer me këste dhe plotësisht në dhjetor të vitit 2015, po në *cash*. Për të provuar këtë pretendim, subjekti ka paraqitur deklaratën me vërtetim nënshkrimi¹⁴, lëshuar nga vëllai G. T., i cili konfirmon deklaratimet e subjektit.

Në DPV-në për vitin 2011 subjekti ka deklaruar këtë hua, si dhe shumën e detyrimit të shlyer dhe të mbetur. Kjo hua është deklaruar rregullisht në DPV-të në vijim deri në DPV-në për vitin 2015, kur është likuiduar totalisht.

36. Në aktin që vërteton marrjen e huas vërehet se në pjesën që pasqyron legalizimin/vërtetimin e nënshkrimeve nga noterja (rreth një vit më vonë se kontrata e huas, datë 6.9.2012), adresa e subjektit përcaktohet: lagjja “K. Q.”, Lushnjë, ndërkohë që si adresë vendbanimi në këtë periudhë subjekti ka deklaruar adresën: lagjja “L. Dh.”, Lushnjë. I pyetur se çfarë përfaqëson kjo adresë, në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti ka deklaruar: “*Adresa: lagjja ‘K. Q.’, Lushnjë, përfaqëson adresën e zyrës noteriale të noteres R. K., pra vendi ku ushtron profesionin noterja*”. Në fakt, deklarimi i subjektit nuk është i besueshëm, pasi në dokumentin “vërtetim nënshkrimi” palët plotësojnë adresën e vendbanimit të tyre dhe jo të noteres. Për më tepër, adresa e noteres në të njëjtin dokument është shënuar “lagjja ‘Ç.’, Lushnjë” dhe siç vërehet adresat janë të ndryshme. Duke qenë se kanë qenë të paqarta arsyet e këtij deklarimi, me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit i është kërkuar të japë sqarime të mëtejshme në lidhje me këtë konstatim.

Në parashtrimet e tij, subjekti ka dhënë sqarime dhe ka paraqitur dokumente, duke vërtetuar se shënimi i adresës *lagjja “K. Q.”, Lushnjë*, ka qenë një gabim material i noteres, e cila ka proceduar sipas nenit 107 të ligjit nr. 110/2018, “Për noterinë” për ndreqjen e tij.

37. Me qëllim verifikimin e burimit të të ardhurave të huadhënësit G. T., në cilësinë e personit tjetër të lidhur, sipas parashikimit të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, u kryen verifikimet, si vijon:

37.1. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar: “*Vëllai im, pasi është kthyer nga Italia rreth vitit 2004, ka filluar të punojë privatisht në Shqipëri si teknik për sistemet hidraulike dhe elektrike. Në vitin 2006 është martuar me shtetasen A. T., e cila ka punuar dhe vazhdon të punojë si mësuese. Që nga marsi i vitit 2007 dhe aktualisht vazhdon të jetë në marrëdhënie pune si teknik për ekspresët e kafesë në shërbim të personit fizik ‘A. C.’, me NIPT ***, me një pagë mujore 40.000 lekë në muaj. Ndërkohë, nga muaji gusht i vitit 2014 e në vazhdim është i punësuar pranë shoqërisë ‘F.’ sh.p.k., me NIPT *** si teknik për ashensorët e kësaj kompanie në qytetin e Lushnjës. Fillimisht pagesa ka qenë në shumën 22.000 lekë në muaj dhe aktualisht është në shumën 26.000 lekë në muaj*”. Për të vërtetuar këto pretendime subjekti ka paraqitur pranë ILDKPKI-së¹⁵ dokumentet përkatëse.

¹⁴Shihni deklaratën me vërtetim nënshkrimi nr. *** rep., nga deklaruesi G. T., bashkëlidhur pyetësorit nr. 2, në dosjen e Komisionit.

¹⁵Shihni në aneksin nr. 4/8 në dosjen ILDKPKI-së: (i) vërtetim, datë 19.10.2016, lëshuar nga shoqëria “F.” sh.p.k., që shtetasit G. T. ka filluar punë nga data 1.8.2014 e në vazhdim, me pagë mujore 22.000 lekë; (ii) vërtetim lëshuar në datën 10.1.2017, nga “A. Ç.”, person fizik, që shtetasi G. T. ka filluar punë në mars të vitit 2007 e në vazhdim, me pagë mujore 40.000 lekë; (iii) kontratë shërbimi (pune) mes shtetasit G. T. dhe “A. Ç.”, person fizik, e lidhur

37.2. Gjatë hetimit administrativ, subjektit iu rikërkua të vërë në dispozicion çdo dokument tjetër ligjor që vërteton të ardhura për të cilat janë paguar detyrimet tatimore/sigurime shoqërore të këtij shtetasi përpara datës 25.1.2011, kur është dhënë huaja. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti informoi se vëllai i tij ka siguruar të ardhura nga puna e tij si emigrant në Itali dhe në Belgjikë për vitet 1999 - 2004, duke deklaruar se: *“Ai është larguar ilegalisht nëpërmjet mjetit lundruës gomone nga bregdeti i Vlorës dhe nuk ka pasur mundësi të pajiset me dokumentacion në këto vende të Europës”* dhe nuk ka provuar me dokumente të ardhura të ligjshme të vëllait të tij për dhënien e huas.

37.3. Subjektit iu kërkua informacion për çdo pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme në pronësi/bashkëpronësi të vëllait G. T. apo bashkëshortes së tij, i cili, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka deklaruar se ata nuk kanë në pronësi pasuri të paluajtshme, duke informuar se disponojnë këto pasuri të luajtshme: një automjet tip “Seat Altea”, vit prodhimi 2010; secili nga një llogari page dhe dy depozita bankare në emër të fëmijëve, duke i vërtetuar këto fakte me dokumente shkresore¹⁶.

37.4. Përveç sa më sipër, në përgjigje të *e-mail*-it të datës 20.10.2021, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. ***, datë 25.7.2007, ku deklaruesit G. T. dhe A. K. deklarojnë se vëllai i subjektit G. T. i ka dhënë në janar të vitit 2006 shtetasit A. K. hua në shumën 1.200.000 lekë, e cila i është kthyer brenda vitit 2007. Subjekti pretendoi se ky dokument duhet të pranohet si provë që vërteton faktin se vëllai i tij ka pasur likuiditete përpara datës 25.1.2011, kur është dhënë huaja tek subjekti. Përkundër nga sa pretendoi subjekti, në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni çmoi se ky dokument shkresor nuk vërteton të ardhura të ligjshme të vëllait të subjektit G. T., sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016 dhe në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

37.5. Nga analiza e të gjitha provave është konstatuar se për periudhën 1.12.2007¹⁷ - 25.1.2011 kur është dhënë huaja, të ardhurat familjare të shtetasit G. T. janë në shumën 484.862 lekë, të cilat përbëhen nga paga e bashkëshortes së tij. Nga këto të ardhura nuk janë zbritur as shpenzimet e jetesës së familjes së G. T. e as krijimi i pasurive të tij. Në këto rrethana, duket se subjekti nuk ka mundur të provojë me dokumentacion të ardhura të ligjshme të mjaftueshme të vëllait të tij për dhënien e shumës 1.800.000 lekë, e cila nuk është përfshirë në analizën financiare të subjektit si e ardhur e ligjshme dhe, për rrjedhojë, subjekti nuk ka justifikuar me të ardhura të ligjshme depozitën *cash* në shumën 15.575 euro, derdhur në datën 28.1.2011 në llogarinë e kredisë në Bankën Kombëtare të Greqisë (sot ABI Bank), e cila ka shërbyer për shlyerjen e parakohshme të kredisë, në të njëjtën datë.

37.6. Në lidhje me shtetasin G. T. janë evidentuar procedime penale të regjistruara në emër të tij¹⁸. Po kështu, nuk ka pasur të dhëna në lidhje me këtë shtetas jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, vërtetuar me informacion konfidencial të organeve kompetente.

38. Në lidhje me mundësinë financiare të subjektit për të shlyer huan prej 1.800.000 lekësh, referuar deklarimeve të subjektit se: për vitin 2011 është shlyer shuma 300.000 lekë; për vitin

në datën 1.3.2007; si dhe (iv) vërtetim nr. *** prot., datë 26.10.2016, nga Zyra Arsimore Lushnjë, për pagën e shtetasit A. T..

¹⁶Shihni vërtetimin nr. *** prot., datë 16.9.2021, dhe nr. *** prot., datë 16.9.2021, lëshuar nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Lushnjë, dhe dokumentet e tjera bashkëlidhur pyetësorit.

¹⁷Kjo është data e fillimit të të ardhurave të bashkëshortes së vëllait G. T., të cilat subjekti i ka paraqitur me pyetësorin nr. 2, si burim për huan e dhënë.

¹⁸Shihni shkresën nr. *** prot., datë 21.9.2021, të SPAK-ut, në dosjen e Komisionit.

2012 është shlyer shuma 400.000 lekë; për vitin 2013 është shlyer shuma 400.000 lekë; për vitin 2014 është shlyer shuma 400.000 lekë; dhe për vitin 2015 është shlyer shuma 300.000 lekë, është kryer analiza financiare e këtyre viteve, ku duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për shlyerjen e kësteve dhe për kryerjen e shpenzimeve apo investimeve të tjera për vitet 2011, 2012 dhe 2015, sikurse pasqyrohet në tabelën në vijim.

Përshkrimi	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015
Pasuri <i>neto</i>	2 464 684	2 554 108	208 167	352 400	672 898
Të ardhura	1 154 894	1 272 074	1 251	1 483 962	1 500 295
Shpenzime	1 043 950	968 336	791 499	875 511	1 028 903
Mundësia për kursime	-2 353 741	-2 250 370	251 850	256 052	-201 506

39. Në një përmbledhje të të dhënave sa i takon burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për pasurinë apartament banimi në O., Vlorë, rezultoi se: (i) shuma 20.000 euro, e përfituar nga kredia në NBG, është konsideruar si burim i ligjshëm; (ii) shuma 4.000 euro, për të cilën duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme, nuk është konsideruar burim i ligjshëm; (iii) shuma 3.000 euro është përfshirë si shpenzim për punimet e kryera gjatë viteve 2010, 2011 dhe 2012, trajtuar në paragrafin 26 të këtij vendimi.

40. Në përfundim të hetimit administrativ, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të vërtetuar të kundërtën e konstatimeve, duket se:

- Ka mospërputhje të çmimit të blerjes në DPV-në për vitin 2008, me kontratën e porosisë së vitit 2008 dhe asaj të shitjes së vitit 2012, ku çmimi i shitjes është deklaruar 27.000 euro dhe në DPV-në për vitin 2012 dhe atë *Vetting*, ku vlera e pasurisë është deklaruar 24.000 euro.
- Në DPV-në për vitet 2008 dhe 2012 dhe në deklaratën *Vetting* nuk është deklaruar burimi i krijimit të pasurisë, sipas nenit 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, “Për deklarinin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar.
- Nuk u justifikua burimi i huas prej 1.800.000 lekësh dhënë nga vëllai G. T. dhe, për pasojë, subjekti nuk ka justifikuar me të ardhura të ligjshme depozitën në *cash*, shumën 15.575 euro, derdhur në datën 28.1.2011, në llogarinë e kredisë në Bankës Kombëtare të Greqisë (sot ABI Bank).
- Subjekti nuk ka pasur mundësi për të justifikuar me të ardhura të ligjshme shlyerjen e huas ndaj vëllait G. T., për shkak të balancave negative për vitet 2011, 2012 dhe 2015, përkatësisht në shumat 2.353.741 lekë, 2.250.370 lekë dhe 201.506 lekë.
- Sipas analizës financiare të kryer deri në këtë moment të hetimit administrativ, duket se subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të investuar vlerën 27.000 euro në pasurinë apartament banimi në O..

41. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe arsyetimi i Komisionit mbi faktet dhe ligjin e zbatueshëm

41.1. Në lidhje me mospërputhjen e çmimit të blerjes prej 27.000 euro, parashikuar në kontratën e shitjes dhe deklaruar në DPV-në për vitin 2008, me çmimin 24.000 euro deklaruar në DPV-në për vitin 2012 dhe deklaratën *Vetting*, në parashtrimet e tij subjekti ka dhënë të njëjtat deklarime, sikurse edhe gjatë procesit të rivlerësimit, sipas të cilave palët kanë pranuar se sendi kishte të meta dhe se kanë rënë dakord që çmimi të ishte në shumën 24.000 euro. Për të mbështetur këtë pretendim subjekti paraqiti si provë aktmarrëveshjen nr. ***, datë 29.10.2021, “Për shkaqet e ndryshimit të çmimit të shitblerjes në kontratën përfundimtare të

shitjes nr. ***, datë 27.9.2012, mes shoqërisë 'O. K.' sh.p.k. dhe subjektit të rivlerësimit". Në këtë aktmarrëveshje, ndër të tjera, palët kanë deklaruar se: (i) në momentin e dorëzimit të sendit palët kanë nënshkruar kontratën e shitjes së pasurisë me çmimin 24.000 euro; si dhe (ii) për shkak të mos plotësimit të detyrimeve të palës shitëse, në përfundim të kontratës me marrëveshje ndryshuan çmimin e shitjes nga 27.000 në 24.000 euro.

41.2. Në analizë të këtij pretendimi, Komisioni arsyeton si vijon:

Së pari, përkundër sa pretendon subjekti, në kontratën e shitjes me nr. ***, datë 27.9.2012, konfirmohet çmimi prej 27.000 euro (i cili ka qene i parashikuar që në kontratën e porosisë nr. ***, datë 4.9.2008), ndërkohë që nuk ka asnjë parashikim për ndryshimin e çmimit të shitjes. Nuk ka asnjë marrëveshje të palëve të lidhur në përfundim të kontratës (apo edhe pas legalizimit të saj), që vërteton vullnetin e tyre për ndryshimin e çmimit të shitjes.

Më tej, në DPV-në për vitin 2012, ku është deklaruar çmimi 24.000 euro, mungon të jetë kryer ndonjë sqarim në lidhje me ndryshimin e çmimit të shitjes. Po kështu, në deklaratën *Vetting*, ku është deklaruar si çmim i blerjes 24.000 euro, subjekti nuk ka kryer asnjë sqarim dhe nuk ka bashkëlidhur asnjë dokument që të vërtetonte dhe justifikonte një çmim shitjeje të ndryshëm nga çmimi i parashikuar në të dyja kontratat që kishin si objekt këtë pasuri, ashtu sikurse neni D i Aneksit të Kushtetutës parashikon se, subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë, në përputhje me ligjin. Ndërsa neni 32 i ligjit nr. 84/2016, parashikon se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

Së dyti, referuar nenit 755 të Kodit Civil, e drejta e blerësit për pakësimin e çmimit parashkruhet dy vjet pas dorëzimit të sendit të paluajtshëm. Ndërsa, referuar nenit 756 të Kodit Civil, e drejta e blerësit për të kundërshtuar të metat e sendit të paluajtshëm parashkruhet me kalimin e pesë vjetëve nga momenti i dorëzimit të sendit. Subjekti nuk paraqiti prova që të vërtetojë se ka ushtruar të drejtën e tij për pakësimin e çmimit apo kundërshtimin e të metave sipas ligjit, por paraqiti aktmarrëveshjen nr. ***, datë 29.10.2021, redaktuar nga palët pas 9 vitesh nga marrja në dorëzim e pasurisë, e cila për më tepër, është paraqitur për herë të parë nga subjekti vetëm pas njohjes me rezultatet e hetimit administrativ, fakt që tregon se ky akt është perpiluar me qëllim justifikimin e mospërputhjeve në deklarinë e çmimit të shitjes së pasurisë, sidomos në kushtet kur është evidentuar që subjekti nuk ka pasur mjaftueshëm të ardhura për të justifikuar investimet në shumën 11.000 euro në këtë pasuri (pasi shuma 20.000 euro ishte paguar me kredi bankare).

Së treti, kontrata e shitjes, e cila parashikon qartë mënyrën e shlyerjes së çmimit prej 27.000 euro: 24.000 euro paguar në datën 3.10.2008, me kalim bankar dhe 3.000 euro janë punime të kryera nga vetë klienti, nuk lë vend për asnjë dyshim që subjekti mund të ketë shpenzuar më pak se vlera 27.000 euro për pasurinë objekt shqyrtimi.

Bazuar në të gjitha sa më sipër, pretendimet e subjektit të rivlerësimit për ndryshimin e çmimit mbeten në nivel deklarativ dhe të pakonfirmuara në kohë reale me dokumentacion në asnjë formë apo mënyrë. Për rrjedhojë, në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, Komisioni vlerësoi të çmojë investimin për blerjen e pasurisë në vlerën 27.000 euro, sikurse është përcaktuar në kontratën e shitjes dhe likuidimin e tij sipas mënyrës së përcaktuar në këtë kontratë, pra, në të njëjtën mënyrë të trajtuar edhe në rezultatet e hetimit administrativ.

41.3. Në lidhje me mosdeklarimin e burimit të krijimit të pasurisë në DPV-në për vitet 2008, 2012 dhe deklaratën *Vetting*, sipas subjektit, edhe nëse konstatohet pasaktësi në plotësimin e një rubrike, në rubrikën e detyrimeve të deklaratave prej tij është deklaruar kontrata e kredisë dhe e huas, që kanë shërbyer si burim për blerjen e kësaj pasurie. Ndërkohë, subjekti pretendon se huaja e marrë nga vëllai nuk ka shërbyer si burim për blerjen e apartamentit, por për të shlyer kredinë e cila ishte marrë për blerjen e tij, në mënyrë që subjekti të mos ngarkohej me pagimin e interesave në favor të bankës. Në fakt, Komisioni nuk ka konstatuar në asnjë moment mosdeklarimin e huas së marrë nga vëllai si burim për blerjen e apartamentit, por ka analizuar mundësinë huadhënëse të këtij të fundit, në cilësinë e personit tjetër të lidhur, sipas kërkesave të ligjit nr. 84/2016.

41.4. Sa i takon mosdeklarimit të burimit për krijimin e pasurisë, është e vërtetë se në rubrikën “Detyrimet financiare” të DPV-së për vitin 2008, subjekti ka deklaruar një kredi që ka shërbyer si burim për blerjen e pasurisë, ndërsa në seksionin e detyrimeve të deklaratës *Vetting* e ka deklaruar këtë kredi të marrë me qëllimin për blerje apartamenti në O., Vlorë. Por, sikurse ka rezultuar nga hetimi administrativ, përveç kredisë në shumën 20.000 euro, subjekti ka përdorur edhe të ardhura të tjera për investimin e pjesës së mbetur prej 7.000 euro dhe, për këtë arsye, ka qenë i domosdoshëm deklarimi i burimit të krijimit të pasurisë në rubrikën përkatëse të deklaratës *Vetting*, sipas parashikimit të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 dhe udhëzimit nr. 4095/2016 të Inspektorit të Përgjithshëm të ILDKPKI-së, sipas te cilit, subjektet e rivlerësimit duhet të deklaronin burimin e krijimit të pasurive, duke iu dhënë mundësia të jepnin sqarime të detajuara dhe paraqitur dokumente shkresore për të justifikuar ligjshmërinë e të ardhurave në momentin e fitimit të tyre.

Në këto rrethana, dhe për më tepër në kushtet kur investimi i pjesës së mbetur prej 7.000 euro nuk është justifikuar me të ardhura të ligjshme, mosdeklarimi i burimit të krijimit të kësaj pasurie në të gjitha deklaratimet e interesave private ndër vite, sipas ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013, i ndryshuar, dhe në deklaratën *Vetting*, sipas dispozitave të sipërpërmendura, përbën një pasaktësi me peshë specifike, e cila është çmuar nga Komisioni si pamjaftueshmëri në deklarime nga subjekti i rivlerësimit.

41.5. Sa i takon mosjustifikimit me të ardhura të ligjshme të huas prej 1.800.000 lekësh prej vëllait të tij G. T., subjekti ka përsëritur të njëjtat deklarata të dhëna gjatë hetimit administrativ, në lidhje me faktin se i vëllai ka punuar si emigrant i paligjshëm në Itali dhe Belgjikë nga viti 1998 dhe se pas vitit 2004 ka punuar në Shqipëri privatisht, por i paregjistruar në organet tatimore. Subjekti sjell në vëmendje edhe një herë si element shumë të rëndësishëm faktin që në janar të vitit 2006 vëllai i tij i ka dhënë hua një shtetasi në shumën 1.200.000 lekë, veprim të cilin e ka provuar me deklaratën noteriale të datës 10.1.2006 (sipas subjektit, kjo deklaratë nuk është kryer për efekt të procesit të rivlerësimit). Subjekti konkludon se të ardhurat e vëllait janë të krijuara para se të ishte subjekt deklarues dhe se ato janë të ligjshme, edhe me argumentin se *në ngarkim të të vëllait nuk ka asnjë proces penal si jashtë, ashtu edhe brenda Shqipërisë.*

Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti paraqiti disa dokumenta shkresore¹⁹.

¹⁹ Bashkëlidhur me parashtrimet shih: (i) deklarata me vërtetim nënshkrimesh lëshuar nga shtetasit Z. Z., Sh. H., G. Sh., K. B., L. L., A. A., I. L., Sh. K., S. K., Z. V., Sh. B. dhe B. N., të cilët kanë pranuar faktin se vëllai i tij G. T. ka kryer shërbime teknike-elektrike dhe montim të kondicionerëve, duke përcaktuar edhe shumat e marra nga secili prej këtyre shtetasve; (ii) deklarata me vërtetim nënshkrimesh nga shtetasit A. Ç., K. L., B. S., B. D., K. Gj., F. H., L. S., G. C. dhe D. R., të cilët kanë pohuar faktin se vëllai i tij G. T. ka punuar për llogari të subjektit A. C., për riparim të ekspresëve të kafesë në aktivitetin e tyre privat.

41.6. Në analizë të parashtrimeve të subjektit dhe akteve shkresore të paraqitura si në parashtrime, ashtu edhe gjatë hetimit administrativ, edhe nëse merret i mirëqenë fakti se në vitin 2006 vëllai i subjektit ka zotëruar vlera monetare, nga të cilat ka dhënë një hua në vlerën 1.200.000 lekë në vitin 2006, përveç faktit që deklarata noteriale që vërteton këtë fakt daton 5 vite më parë se të jepej huaja (në vitin 2011), subjekti nuk ka mundur të provojë me dokumentacion të ardhura të ligjshme të huadhënësit G. T., në kuptim të pikës 3, të nenit D, të ligjit nr. 84/2016. Për këtë arsye, shuma 1.800.000 lekë nuk është konsideruar si burim për shlyerjen totale të parakohshme të kredisë në NBG në datën 28.1.2011.

41.7. Sa i takon konstatimit se subjekti nuk ka pasur mundësi për të justifikuar me të ardhura të ligjshme shlyerjen e huas ndaj vëllait G. T., për shkak të balancave negative për vitet 2011, 2012 dhe 2015, subjekti i ka kundërshtuar këto balanca nëpërmjet një analize financiare të propozuar prej tij²⁰, sipas të cilës, ndryshe nga përllogaritjet e Komisionit, rezultojnë diferenca negative minimale të cilat vijnë si rrjedhojë e marrjes në konsideratë të disa elementeve të cilat janë trajtuar hollësisht dhe janë prezantuar në paragrafin 90 të këtij vendimi.

41.8. Sa i takon konstatimit se *subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të investuar vlerën 27.000 euro në pasurinë apartament banimi në O.*, në prapësimet e tij, subjekti ka paraqitur kundërshtime në lidhje me vlerën e investimit prej 7.000 euro, si vijon:

Së pari, subjekti ka përsëritur edhe një herë deklaratimet e bëra në pyetësonin nr. 2, duke pretenduar se shuma 400.000 lekë, e deklaruar si gjendje *cash* në DPDFD në vitin 2007, është përdorur në vitin 2008 për pagesën e shumës 4.000 euro për blerjen e apartamentit në O.. Ky pretendim nuk qëndron, pasi: (i) subjekti nuk ka deklaruar as gjendje, as ndryshime të gjendjes *cash* në DPV/2007, duke lënë të kuptohet se gjendja *cash* është 0 (zero); (ii) subjekti nuk e ka deklaruar përdorimin e kësaj shume *cash* në DPV/2008; (iii) nga deklaratimet e gjendjes *cash* ndër vite është konkluduar se subjekti ka deklaruar gjendje dhe jo shtesa të gjendjes *cash*, sikurse trajtuar hollësisht në paragrafin 83 të këtij vendimi, e kështu, sipas deklaratimit të vitit 2007 gjendja *cash* prezumohet të jetë 0 (zero)²¹.

Së dyti, sa i takon shpenzimit prej 3.000 euro, subjekti ka vijuar të kundërshtojë pagesën e kësaj shume, duke pretenduar se çmimi i apartamentit ishte ulur, pretendim i cili nuk u çmua i bazuar nga Komisioni (arsyetuar në paragrafin 41.2 të këtij vendimi).

42. Bazuar në të gjitha faktet dhe provat e administruara, sa i takon apartamentit të banimit në O., Vlorë, në përfundim të këtij procesi, subjekti nuk arriti të kundërshtojë barrën e provës, pasi ka kryer: (i) deklarime të pasakta dhe në kundërshtim me ligjin, sipas germës “a”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016; (ii) nuk ka justifikuar me të ardhura të ligjshme sipas germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016 investimin në total prej 27.000 euro, si dhe shlyerjen e kredisë prej 20.000 euro.

Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar pasurinë:

43. *Automjet tip “Mercedes-Benz 211020 E280 CDI”, kontrata e blerjes nr. ***, datë 27.12.2016, redaktuar para noterit J. Q., Lushnjë. Vlera: 600.000 (gjashtëqind mijë) lekë.*

²⁰Sipas kësaj analize rezultatet e viteve në të cilat subjekti ka shlyer huan ndaj vëllait të tij janë: viti 2011 rezulton me balancë -71 604 lekë; viti 2012 rezulton me balancë -110 625 lekë; viti 2013 rezulton me balancë 437 228 lekë; viti 2014 rezulton me balancë 461 747; viti 2015 rezulton me balancë -16 833 lekë.

²¹Në DPV/2007 të plotësuar dhe dorëzuar pranë ILDKPKI në datën 7.3.2008, subjekti nuk ka deklaruar asgjë në lidhje me gjendjen *cash*, por duke parë në vijueshmëri mënyrën e deklaratimit të gjendjes *cash* për vitet 2009 – 2016, evidentohet se subjekti është shumë i qartë në deklaratimet e tij dhe se shumata e deklaruara janë gjendje *cash* dhe jo shtesa/pakësime të tij.

Pjesa takuese: 100 %. Nuk është deklaruar burimi i krijimit dhe nuk është identifikuar targa e automjetit.

ILDKPKI-ja nuk ka konstatuar problematika në lidhje me këtë pasuri. Gjatë hetimit administrativ DPSHTRR-ja²² ka konfirmuar se në emër të shtetasit Ervin A. Trashi është i regjistruar automjeti me targa ***. Nga dokumentacioni bashkëlidhur konfirmohet se bëhet fjalë për të njëjtin automjet të deklaruar nga subjekti.

Hetimi i Komisionit në lidhje me këtë pasuri

44. Në lidhje me këtë automjet, referuar akteve të vëna në dispozicion nga DSHPTRR-ja, në rend kronologjik janë kryer veprimet si vijojnë:

- Me faturë, datë 7.9.2012, lëshuar nga G. A. S.p.a., shtetasi A. M. ka blerë automjetin tip “Mercedes-Benz”, me targa ***, me nr. shasie ***, në vlerën 10.330,58 euro dhe sipas deklaratës doganore të datës 17.9.2012, detyrimi doganor prej 343.338 lekësh është paguar nga ky shtetas.

- Me kontratën e shitjes datë 17.9.2012 (jo noteriale), “A. M.” sh.p.k., me NIPT *** (sipas ekstraktit të marrë në faqen e QKB-së, “A. M.” është person fizik me qendër në Gjirokastrë), i shet shtetasit Z. B. (burri i tezes së subjektit) automjetin tip “Daimler ***”, e vitit 2008, në shumën 600.000 lekë, si dhe ka lëshuar faturën tatimore nr. ***, datë 17.9.2012, ku përcaktohet shasia e automjetit nr. ***, çmimi 500.000 lekë dhe 100.000 lekë TVSH.

- Sipas certifikatës së pronësisë datë 24.9.2012, automjeti me targa ***, me nr. Shasie ***, u regjistrua në pronësi të shtetasit Z. Z. B. dhe vetëm dy ditë më vonë, në datën 26.9.2012, automjeti pajiset me TPL²³, ku figuron si i siguarur z. Ervin Trashi dhe përfitues Z. B..

- Me deklaratën noteriale nr. ***, datë 18.10.2012²⁴ (një muaj më vonë nga regjistrimi i mjetit) shtetasi Z. B. i ka dhënë automjetin në përdorim subjektit të rivlerësimit pa afat dhe pa kundërshpërbllim.

- Me kontratën e shitblerjes së automjetit nr. ***, datë 5.2.2016, shtetasi Z. B. i ka shitur shtetasit A. L. këtë automjet, në çmimin 800.000 lekë.

- Sipas certifikatës së pronësisë datë 8.2.2016, shtetasi A. L. regjistroi automjetin në emër të tij. Nga të dhënat në sistemin e AMF-së nuk rezultojnë asnjë policë sigurimi në emër të shtetasit A. L. gjatë periudhës që e ka pasur në pronësi këtë automjet, ndërkohë që në policën e sigurimit subjekti i rivlerësimit figuron si pronar i automjetit.

- Me prokurën e posaçme nr. ***, datë 26.2.2016²⁵ (15 ditë më vonë pasi e bleu automjetin) A. L. ka emëruar si përfaqësues të posaçëm subjektin, të cilit i jep të drejtë ta përdorë, administrojë, të nënshkruajë kontrata qiraje, huapërdorjeje dhe kontratë shitjeje, për automjetin për një periudhë pa afat (kjo në fakt është një prokurë me të drejta të përgjithshme).

- Me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 27.12.2016²⁶, shtetasi A. L. i ka shitur subjektit Ervin Trashi automjetin në çmimin 600.000 lekë, shumë e cila është paguar para përpilimit të kontratës, jashtë zyrës noteriale. I pyetur mbi mënyrën e kalimit të shumës 600.000 lekë tek shitësi, duke vërtetuar me dokumente, në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti ka deklaruar se kalimi i kësaj shume në favor të shitësit A. L. është kryer në *cash*, për të cilën ka paraqitur deklaratë jo noteriale²⁷ të këtij shtetasi, që konfirmon deklaratimet e subjektit.

²²Shihni shkresën nr. *** prot., datë 11.5.2020, të DPSHTRR-së, në dosjen e Komisionit.

²³Shihni përgjigjen, datë 19.5.2020, të AMF-së dhe dokumentet bashkëlidhur, TPL-në me nr. serie ***, në dosjen e Komisionit.

²⁴Bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2.

²⁵Ky akt noterial figuron në RNSH, sipas shkresës nr. *** prot., datë 8.5.2020, të Ministrisë së Drejtësisë në dosjen e Komisionit.

²⁶Shihni aneksin nr. 4/3, në dosjen ILDKPKI-së dhe dokumentacionin bashkëlidhur shkresës nr. *** prot., datë 11.5.2020, të DPSHTRR-së, në dosjen e Komisionit.

²⁷Shihni deklaratën (shkresë jo noteriale) e shtetasit A. L., bashkëlidhur pyetësorit nr. 2, në dosjen e Komisionit.

- Në DPV-në për vitin 2016, subjekti ka deklaruar blerjen e automjetit me shënimin “kursime nga paga e viteve 2015 dhe 2016”.

- Sipas dokumentit “leja e qarkullimit rrugor dhe të dhënat lidhur me të”, e datës 23.2.2017, automjeti me targa *** është regjistruar në pronësi të z. Ervin Trashi.

- Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar se e ka përdorur këtë automjet që në periudhën që ka qenë në pronësi të burrit të tezes Z. B., si dhe në kohën kur ka qenë në pronësi të mikut të tij të fëmijërisë A. L..

45. Nga të dhënat e administruara më sipër, vërtetohet se subjekti e ka përdorur automjetin, objekt shqyrtimi, menjëherë pasi blerësi i parë Z. B. e ka regjistruar automjetin në emër të tij në datën 26.9.2012, e në vijimësi, menjëherë pasi blerësi i dytë A. L. e ka blerë automjetin në datën 5.2.2016, deri në momentin që këtë automjet e ka blerë vetë nga shtetasi A. L. në datën 27.12.2016. Në këto rrethana, shtetasit Z. B. dhe A. L., në cilësinë e huadhënësve, janë konsideruar persona të tjerë të lidhur, në kuptim të pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016. Për këtë arsye, si dhe për të hequr çdo dyshim që automjeti mund të jetë blerë nga subjekti i rivlerësimit që në vitin 2012, Komisioni ka kryer disa hetime, sipas të cilave ka rezultuar se:

45.1. Subjekti u pyet në lidhje me marrëdhënien me shtetasin A. M., si dhe në ç'rrethana ky shtetas, i cili e kishte blerë automjetin në shumën 10.330,58 euro + 343,338 lekë zhdoganimin, ia shiti burrit të tezes së tij Z. B., brenda 10 ditësh, në shumën 600.000 lekë. Subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka deklaruar se nuk e njeh dhe nuk ka asnjë kontakt me shtetasin A. M. dhe se nuk ka qenë në dijeni të këtij fakti. Por, sipas informacionit të marrë nga shtetasi Z. B., subjekti bën me dije se *ky shtetas e kishte blerë automjetin në shumën 13.000 euro dhe jo në shumën e përcaktuar në kontratë dhe se çmimi prej 600.000 lekësh është vënë në kontratën e shitjes me kërkesë të shitësit A. M.* Siç vërehet, shuma e deklaruar nga subjekti prej 13.000 euro, si çmim i blerjes nga shtetasi Z. B., është një çmim logjik referuar çmimit të blerjes dhe shpenzimeve të zhdoganimit të paguara nga shitësi i parë A. M.. Në këto rrethana, gjatë analizës që i është bërë burimit të të ardhurave për blerjen e këtij automjeti, në përfundim të hetimit administrativ nga Komisioni si çmim blerjeje i automjetit nga shtetasi Z. B. në vitin 2012 është konsideruar vlera 13.000 euro.

45.2. Nga të dhënat në sistemin *TIMS*, automjeti është përdorur disa herë nga subjekti për kalimin e kufirit gjatë kohës që ishte në pronësi të blerësit të parë Z. B.. Ndërkohë, rezulton që shtetasi Z. B. ka kaluar disa herë kufirin jo me këtë automjet, por me mjete të tjera. I pyetur në lidhje me këtë fakt, në përgjigje të *e-mail*-it të dërguar në datën 12.10.2021, subjekti ka deklaruar se nuk ka informacion. Ndërsa, në *e-mail*-in e datës 20.10.2021, ka sqaruar se z. Z. B. në këtë periudhë ka qenë i punësuar si shofer në shoqërinë “M.” sh.p.k. dhe ka përdorur për llogari të punës automjetin me targa ***. Sipas subjektit, ky shtetas nuk ka qenë asnjëherë në Itali, por për efekt të procedurave të zhdoganimit të mallit, me makinën e tij duhej të kryente lëvizjet në ambientet e brendshme të portit dhe në disa raste punonjës të policisë kufitare merrnin të dhënat e ID-së së tij. Këto pretendime jo vetëm që janë në kuadër deklarativ, por bien në kundërshtim me të dhënat e sistemit *TIMS*, sipas të cilit shtetasi Z. B. ka pasur disa hyrje-dalje me disa ditë qëndrimi në Itali.

45.3. Nga të dhënat në sistemin *TIMS*, blerësi i dytë A. L. nuk rezulton të ketë kaluar kufirin me këtë automjet, ndërkohë që nga momenti i blerjes më 5.2.2016, e deri sa e shiti më 27.12.2016, ky shtetas ka qëndruar në periudha të caktuara në Shqipëri, gjithsej rreth dy muaj. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti deklaroi se ky shtetas banon në Itali. Këto fakte hedhin dritë mbi dyshimin që ky shtetas nuk e ka përdorur automjetin në Shqipëri e jashtë saj.

45.4. Gjykatat e rrethit Gjirokastrë dhe Vlorë, ku subjekti ka ushtruar detyrën²⁸ nuk konfirmojnë procese të trajtuara nga subjekti ku palë kanë qenë shtetasit Z. B., A. L. dhe A. M.. Po kështu, pas kërkesës së Komisionit, SPAK-u²⁹ nuk ka konfirmuar procedime penale të regjistruara në emër të tyre.

45.5. Sa i takon të ardhurave të shtetasve Z. B. dhe A. L. për blerjen e këtij automjeti, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se:

a. Shtetasi Z. B. ka ushtruar profesionin si mekanik për periudhën 1993 – 2014, por të pa regjistruar në organet shtetërore dhe se objekti ku ka ushtruar këtë aktivitet, për shkak se ka qenë pa leje, është prishur në vitin 2014. Subjekti paraqiti: (i) disa dokumente në emër të shtetasit D. B., pa sqaruar relatat me shtetasin Z. B.; (ii) librezë pune të shtetasit Z. B.; (iii) vërtetim për të vetëpunësuarit në bujqësi, të datës 21.9.2021, e DRSH-së Fier, të shtetasit Z. B., për periudhën 31.12.1994 – 31.12.2006; (iv) vërtetime për bazën e vlerësueshme për shtetasin L. B., pa sqaruar relatat me shtetasin Z. B., për periudhën 1994 – 2011 nga shkolla “J. N.”; (v) ekstrakt nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për periudhën dhjetor 2011 – qershor 2021; (vi) ortofoto nga gjeoportali nëpërmjet të cilës subjekti kërkon të provojë se shtetasi Z. B. ka punuar si mekanik në një ndërtesë e cila është shembur dhe nuk ekziston në vitin 2015.

Në analizë të dokumenteve të paraqitura, subjekti: (i) nuk ka mundur të provojë me dokumentacion shkresor të ardhura të shtetasit Z. B.; (ii) për të ardhurat e shtetasit L. B. ka paraqitur dokumente që nga dhjetori i vitit 2011 deri në gusht të vitit 2021. Të ardhurat e saj për periudhën dhjetor 2011 – 17.9.2012, kur është blerë makina nga shtetasi Z. B. janë 231.703 lekë, ndërsa shpenzimet e saj të jetesës për të njëjtën periudhë janë në shumën 235.467 lekë; (iii) shtetasi D. B., i cili jeton dhe punon në Itali, nga shtatori i vitit 2007 deri dhjetor të vitit 2009 ka pasur të ardhura në shumën 23.834 euro, ndërsa shpenzime jetese sipas EUROSTAT-it³⁰, për të njëjtën periudhë, në shumën 21.768 euro. Pra, mundësia për kursime e këtij shtetasi është 2.066 euro. Siç vërehet, nuk vërtetohen të ardhura të ligjshme të shtetasit Z. B. për të paguar çmimin e blerjes së automjetit prej 13.000 euro në vitin 2012, fakt që thëllon dyshimet që automjeti mund të jetë blerë nga subjekti i rivlerësimit në këtë vit.

b. Sa i takon shtetasit A. L., i cili jeton në Itali, subjekti ka paraqitur dokumentin *Estratto Conto Previdenziale të INPS* (shteti italian). Sipas këtij dokumenti, të ardhurat e ligjshme të tij nga maji i vitit 2001 deri më 5.2.2016 janë në shumën 150.783 euro, ndërsa shpenzimet për një person janë 127.392 euro. Mundësia për kursime e këtij shtetasi është 23.391 euro, e cila e lejon blerjen e automjetit në vlerën 800.000 lekë në shkurt të vitit 2016.

Në lidhje me burimin e krijimit të automjetit

46. Në deklaratën *Vetting*, subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie, por në DPV-në për vitin 2016 ka deklaruar si burim kursimet nga pagat e viteve 2015 dhe 2016.

47. Pavarësisht se subjekti e ka blerë dhe deklaruar automjetin, objekt shqyrtimi, në vitin 2016 me çmimin 600.000 lekë, gjatë hetimit administrativ u administruan prova e fakte, sipas të cilave subjekti është sjellë si pronar i mjetit që në vitin 2012, duke krijuar dyshime të forta se

²⁸Shihni shkresën nr. *** prot., datë 13.9.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, shkresën nr. *** port., datë 17.9.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe shkresën nr. *** prot., datë 21.9.2021, të SPAK-ut, në dosjen e Komisionit.

²⁹Shihni shkresën nr. *** prot., datë 21.9.2021, të SPAK-ut, në dosjen e Komisionit.

³⁰<https://appsso.eurostat.ec.europa.eu/nui/submitViewTableAction.do>

është blerë prej tij gjatë këtij viti në çmimin 13.000 euro. Konkretisht, në mënyrë të përmbledhur, u vërtetua se: (i) subjekti ka deklaruar se mjeti është blerë prej shtetasit A. M. me çmimin 13.000 euro dhe jo 600.000 lekë, ndërkohë që nuk janë vërtetuar të ardhura të ligjshme të blerësit të parë Z. B. për blerjen e mjetit në vlerën 13.000 euro në vitin 2012; (ii) menjëherë pas regjistrimit të këtij mjeti në emër të shtetasit Z. B., subjekti është lejuar me akt shkresor të përdorë mjetin, i cili është pajisur me TPL, ku figuron si i siguruar Ervin Trashi dhe përfitues Z. B.; (iii) subjekti e ka përdorur mjetin brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, ndërkohë që vetë shtetasi Z. B. nuk e ka përdorur asnjëherë mjetin jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë; (iv) menjëherë pasi pronari i dytë A. L. ka fituar pronësinë, i ka dhënë të drejta të plota mbi mjetin subjektit, ndërkohë që vetë ka banuar në Itali dhe nuk rezulton të ketë kaluar ndonjëherë kufirin me këtë mjet; si dhe (v) nuk rezulton asnjë policë sigurimi në emër të shtetasit A. L., ndërkohë që pronar i mjetit në policë figuron subjekti i rivlerësimit.

48. Bazuar në sa më sipër, Komisioni ka verifikuar mundësinë financiare të subjektit për ta blerë mjetin në çmimin 13.000 euro në vitin 2012 dhe nga analiza financiare në përfundim të hetimit administrativ³¹, duket se ai nuk ka pasur mundësi me të ardhura të ligjshme për të paguar shumën 13.000 euro në datën 17.9.2012, për shkak të një balance negative prej 2.250.370 lekësh.

Përshkrimi	Viti 2012
Pasuri	2 154 108
Shpenzime për punime të kryera në apartament	139 720
Automjet tip “Mercedes-Benz”	1 816 360
<i>Ndryshim likuiditetesh</i>	<i>198 028</i>
Total likuiditete	270 700
Të ardhura	1 272 074
Të ardhura nga pagat, subjekti	813 316
Të ardhura nga pagat dhe pensioni, babai	170 298
Të ardhura nga pagat dhe pensioni, nëna	288 460
Shpenzime	1 368 336
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së	418 644
Shpenzime udhëtimi sipas sistemit TIMS-it	331 988
Shpenzime transporti	169 400
Paguar huaja ndaj vëllait	400 000
Shpenzime arredimi (sipas P.2)	25 000
Shpenzime të tjera të evidentuara, ALUIZNI	23 304
Mundësia për kursime	-2 250 370

49. Në përfundim të hetimit administrativ në lidhje me mjetin, objekt shqyrtimi, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të vërtetuar të kundërtën e konstatimeve, duket se: (i) në deklaratën *Vetting* subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie; (ii) ngrihen dyshime të arsyeshme bazuar në prova që mjeti është blerë prej subjektit të rivlerësimit në vitin 2012, vit në të cilin nuk është deklaruar sipas ligjit dhe subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme për blerjen e tij, për shkak të një balance negative prej 2.250.370 lekësh.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe arsyetimi i Komisionit mbi faktet dhe ligjin e zbatueshëm

³¹Kjo analizë mund të ndryshonte në varësi të kundërshtimit të barrës së provës nga subjekti.

50. Në lidhje me mosdeklarimin e burimit të krijimit të kësaj pasurie në deklaratën *Vetting*, subjekti pretendon se ka qenë një lapsus, ndërkohë që, pa të drejtë i referohet faktit që burimi i kësaj pasurie është kontrata e blerjes, pasi në fakt kontrata e blerjes është vetëm akti që formalizon vullnetin e palëve dhe nuk vërteton burimin e krijimit të pasurisë. Gjithashtu, subjekti pretendon që çdo rast mungesa e deklarimit të burimit nuk mund të interpretohet si e qëllimshme dhe përdor në mënyrë të gabuar si argument faktin që vlera e mjetit është shënuar në aktet bashkëlidhur deklaratës *Vetting* (shënimi i vlerës së mjetit nuk justifikon mosdeklarimin e burimit). Për sa pretendohet nga subjekti, mosdeklarimi i burimit të pasurive sipas kërkesave të ligjit, në kushtet kur nuk është vërtetuar mundësia financiare për blerjen e tij, merr një peshë specifike të posaçme dhe bazuar në një vlerësim tërësor të rrethanave bëhet shkak për penalizim të subjektit të rivlerësimit.

Veç sa më sipër, vlen të theksohet se në mënyrë të përsëritur subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pasurive, duke e justifikuar këtë mosveprim si një lapsus apo pasaktësi të paqëllimshme në deklarime, ndërkohë që vërehet se në jo pak raste ka qenë i saktë në deklarime, si në rastin e deklarimeve të detyrimeve financiare për shkak të kredisë në shumën 20.000 euro dhe huas prej 1.800.000 lekësh marrë nga vëllai i tij.

51. Në lidhje me dyshimet e ngritura nga Komisioni se ky mjet është blerë nga subjekti në vitin 2012, në përpjekje për të argumentuar se ky dyshim është i pabazuar, në parashtrimet e tij subjekti ka dhënë të njëjtat deklarime si dhe gjatë procesit të rivlerësimit, duke pretenduar se gjatë kohës që mjeti ka qenë në pronësi të burrit të tezes Z. B., i është lënë në përdorim prej tij me vullnet të lirë të formalizuar me një akt shkresor, për shkak të marrëdhënieve të afërta me të dhe nevojave familjare të subjektit. Subjekti sjell në vëmendjen e Komisionit edhe qëndrimin e Kolegjit në vendimin nr. 24, datë 18.7.2021, ku sipas tij situata ka qenë e njëjtë. Ndërsa, në seancën dëgjimore, duke u shprehur për këtë automjet “*të jem i sinqertë më ka pëlqyer shumë*”, ka deklaruar gjithashtu se në fakt e ka përdorur në kushtet kur ishte pa automjet dhe në pamundësi për ta blerë, ndërkohë që burri i tezes nuk ka pasur ndonjë domosdoshmëri për ta pasur gjatë gjithë kohës.

52. Në lidhje me shetasin Z. B. subjekti parashtrroi:

52.1. Sa i takon konstatimit se mjeti nuk është përdorur gjatë gjithë kohës për të dalë jashtë shtetit prej këtij shtetasi, subjekti mban të njëjtin qëndrim si dhe gjatë hetimit administrativ, duke pretenduar se shtetasi Z. B. ka qenë i punësuar si shofer në shoqërinë “M.” sh.p.k. dhe ka përdorur për llogari të punës mjetin me targa ***, dhe se ky shtetas nuk ka qenë asnjëherë në Itali, sikurse tregon raporti i sistemit *TIMS*. Ndërkohë nuk ka paraqitur asnjë dokument shkresor për të vërtetuar pretendimet e tij.

Në analizë të këtij pretendimi, nga Komisioni u krye riverifikimi i të dhënave të sistemit *TIMS*, sipas të cilit rezultoi që shtetasi Z. B. ka pasur: (i) dalje: në datën 8.11.2014, me targa ***; në datën 14.2.2015, me targa ***; në datën 19.2.2015, me targa ***; në datën 24.3.2015, me targa ***; në datën 28.4.2015, me targa ***; në datën 24.6.2015, me targa ***; në datën 7.7.2015, me targa ***; dhe (ii) hyrje: në datën 23.3.2014, me targa ***; në datën 11.5.2014, me targa ***; në datën 27.6.2014, me targa ***; në datën 12.5.2015, me targa ***.

Siç vërehet, shtetasi Z. B.: (i) ka pasur hyrje-dalje dhe ditë qëndrimi jashtë shtetit dhe në asnjë rast nuk ka udhëtuar me mjetin në pronësi të tij me targa ***; (ii) përveç mjetit të pretenduar nga subjekti, me targa ***, ky shtetas ka pasur disa dalje/hyrje edhe me mjete të tjera.

52.2 Sa i takon çmimit të blerjes së mjetit nga shtetasi Z. B., pavarësisht se në përgjigje të pyetësorit nr. 2 subjekti ka pranuar që sipas thënieve të këtij shtetasi, mjete ishte blerë prej tij në çmimin 13.000 euro dhe jo në çmimin 600.000 lekë, në parashtrimet e tij subjekti pretendoi që si vlerë e blerjes së mjetit nuk duhet të konsiderohet shuma 13.000 euro, pasi kjo mbetet në nivel deklarativ, por duhet të konsiderohet çmimi 600.000 lekë sipas faturës së shitjes nga shtetasi A. M., vlerë që sipas tij, shtetasi Z. B. ka pasur të ardhura të mjaftueshme për ta paguar³², duke iu referuar vendimeve nr. 11/2019 dhe nr. 5/2019, të Kolegjit, në të cilat konsiderohet çmimi i blerjes së pasurive, sipas kontratave noteriale.

53. Në lidhje me shtetasin A. L., subjekti deklaroi se sy shtetas nuk e ka përdorur mjetin, pasi ka qenë me banim në Itali dhe se ai duhet ta kishte ndërruar emrin e pronarit (që ishte subjekti i rivlerësimit) në policën e sigurimit, veprim të cilin nuk e ka kryer, ndoshta për shkak edhe të kohës së shkurtër të qëndrimit në Shqipëri. Për Komisionin mbetet e paqarte dhe e pakuptimtë përse ky shtetas e bleu mjetin ndërkohë që banonte në Itali dhe menjëherë pas blerjes, i ka dhënë të drejta të plota subjektit për ta përdorur, përfshirë edhe të drejtën për t'ia lënë në përdorim një personi tjetër, si dhe për t'ia shitur personave të tretë, përfshirë edhe veten. Këto rrethana, si dhe fakti që disa muaj pas blerjes shtetasi A. L. ia shiti këtë mjet subjektit, tregojnë se kontrata e shitjes nr. ***, datë 5.2.2016, me të cilën shtetasi Z. B. i ka shitur shtetasit A. L. këtë mjet në çmimin 800.000 lekë, është një kontratë fiktive, pasi blerësi real i mjetit ka qenë subjekti dhe jo A. L..

54. Në analizë të deklaramëve gjatë gjithë procesit të rivlerësimit si dhe dokumenteve të paraqitura, në përfundim të procesit të rivlerësimit Komisioni çmoi se subjekti nuk ka qenë bindës në argumentet e tij dhe në këtë mënyrë nuk ka mundur të provojë të kundërtën e barrës së provës, arsyetuar si vijon:

54.1. Vendimi nr. 24, datë 18.7.2021, i Kolegjit, të cilit i referohet subjekti, përcaktoi se: *“Lidhur me përdorimin e automjetit tip Benz, me targa {***}, meqenëse subjekti ka deklaruar përdorimin e automjetit në pronësi të kushëririt të tij B. H., Komisioni e ka konsideruar këtë të fundit si person tjetër i lidhur, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe nuk rezultoi që Komisioni të ketë ngritur ndaj subjektit ndonjë dyshim apo të ketë kaluar barrë prove për ndonjë rrethanë që mund të çonte te hipoteza e një pasurie të fshehur të subjektit”.*

54.2. Siç vërehet në këtë vendim, ashtu sikurse edhe në disa raste të tjera, Kolegji ka standardizuar qëndrimin e Komisionit për hetimin e pasurive në përdorim të subjekteve të rivlerësimit në rastet kur ka dyshime të arsyeshme për pronësi të fshehur të subjekteve në pasuritë e marra në përdorim/huapërdorje. Në rastin e subjektit Ervin Trashi, në përfundim të hetimeve, Komisioni evidentoi fakte dhe rrethana që tregojnë se ai është sjellë në mënyrë të vazhdueshme si pronar i mjetit që në momentin e blerjes nga shtetasi Z. B. në vitin 2012 derisa mjete u ble prej tij në vitin 2016 dhe, për rrjedhojë, ka pasur dyshime të arsyeshme që mjete mund të jetë blerë prej tij që në vitin 2012, duke ngritur hipoteza për një pasuri të fshehur të subjektit. Edhe pas kalimit të barrës së provës, subjekti nuk arriti të kundërshtojë bindshëm faktet dhe rrethanat e konstatuara gjatë hetimit administrativ.

54.3. Në këto kushte, Komisioni verifikoi mundësinë e blerjes së mjetit me të ardhura të ligjshme në të gjitha versionet e mundshme, në varësi të provave apo dyshimeve të ngritura. Konkretisht:

³²Shihni dokumentet shkresore të paraqitura në parashtrime me të cilat pretendohet se vërtetohen të ardhura të shtetasit Z. B. për të blerë mjetin në çmimin 600.000 lekë në vitin 2012.

- U verifikua mundësia e shtetasit Z. B. dhe subjektit për të blerë mjetin në vlerën 13.000 euro në vitin 2012, nga ku ka rezultuar se të dy nuk kanë pasur mundësi financiare me të ardhura të ligjshme.

- Pavarësisht se konsiderimi i vlerës së shitjes së mjetit prej 600.000 lekësh, ashtu sikurse subjekti pretendon, vetëm një javë pasi shtetasi A. M. e kishte blerë e zhdoganuar në vlerën totale 13.000 euro, është jashtë logjikës ekonomike dhe i pajustificuar financiarisht, nga ana e Komisionit u verifikua mundësia e shtetasit Z. B. dhe subjektit për të blerë mjetin në vlerën 600.000 lekë në vitin 2012, nga ku ka rezultuar se të dy nuk kanë pasur mundësi financiare me të ardhura të ligjshme për të paguar këtë shumë.

54.4. Bazuar në të gjitha sa është arsyetuar në këtë vendim, në përfundim të procesit, edhe pse nuk mund të thuhet se mjeti është blerë *de jure* nga subjekti që në vitin 2012, duket se ai e ka blerë *de facto* në këtë vit. Me veprimet dhe mosveprimet e tij në vitet në vijim, subjekti është përpjekur të fshehtë këtë fakt derisa e bleu juridikisht këtë mjet në datën 27.12.2016, pikërisht për shkak se nuk ka pasur burime të ligjshme për blerjen e tij në vitin 2012 në çmimin 13.000 euro dhe as në çmimin 600.000 lekë.

54.5. Pavarësisht nga ky vlerësim, në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, Komisioni kreu analizën financiare në variantin e paraqitur nga subjekti dhe çmoi të konsiderojë pretendimet e tij në lidhje me vlerën e blerjes së mjetit në një qasje garantiste, duke iu referuar çmimit të blerjes së pasurisë prej 600.000 lekësh³³ të përcaktuar në kontratën e shitjes së pasurisë të vitit 2016, dhe jo deklarimit të subjektit në përgjigje të pyetësorit nr. 2, sipas të cilit vlera e blerjes së mjetit në vitin 2010 ka qënë 13.000 euro. Sipas kësaj analize, subjekti nuk ka pasur mjaftueshëm të ardhura të ligjshme për blerjen e mjetit në vitin 2016 për shkak të një balance negative prej - 433.048 lekësh. Për rrjedhojë, analiza financiare e vitit 2016, dërguar subjektit me rezultatet e hetimit administrativ në përfundim të procesit, ndryshon nga +116.952 lekë në -433.048 lekë. Gjithashtu, është rishikuar edhe analiza financiare për vitin 2012, vit në të cilin ishte konsideruar blerja e mjetit nga subjekti në shumën 13.000 euro, dhe rezultati financiar i vitit 2012 ka ndryshuar nga -2.250.370 lekë, në -384.010 lekë.

Në procesin e vlerësimit përfundimtar, balancat negative të rezultura dhe qëndrimet e subjektit në lidhje me dyshimet e ngritura për një pasuri të blerë prej tij që në vitin 2012, janë konsideruar si shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar pasurinë:

55. Gjendje *cash* në vlerën 400.000 lekë. Pjesa *takuese*: 100%. Nga hetimi administrativ ka rezultuar se kjo gjendje *cash* është mbartur nga fundi i vitit 2016, pasi në DPV/2016 subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në shumën 400.000 lekë. Sa i takon mundësisë financiare për të krijuar kursime *cash* gjatë vitit 2016, nga analiza financiare e këtij viti ka rezultuar se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e kësaj gjendjeje *cash*.

Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar pasurinë:

56. Automjet tip “Nissan Primera”. Kontrata e blerjes nr. ***, datë 15.10.2007, redaktuar para noterit L. G. – Lushnje. Vlera: 200.000 lekë. Pjesa *takuese*: 100%. Subjekti nuk e ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie.

³³Burimi i deklaruar nga subjekti në DPV/2007 është: kursimet nga pagat e vitit 2015 dhe 2016. Nga verifikimi i DPV/2015 rezultoi se subjekti ka deklaruar shumën 400.000 lekë si kursim nga paga, gjendje *cash*. Nga analiza financiare e vitit 2015, subjekti ka rezultuar me balancë negative e kështu nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e shumës *cash* 400.000 lekë në vitin 2015.

DPSHTRR-ja³⁴, gjatë hetimit administrativ, nuk ka konfirmuar të regjistruar në emër të subjektit këtë automjet, por me shkresën nr. *** prot., datë 18.7.2017, konfirmon se subjekti, deri në datën 26.1.2017, nuk ka në pronësi automjet të regjistruar. Siç vërehet, subjekti ka deklaruar këtë automjet, ndërkohë që nuk e ka pasur në pronësi në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting*.

57. Në lidhje me origjinën dhe mënyrën e krijimit, nga aktet³⁵ në dosje rezulton se:

- Sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 15.10.2007, shtetasi Ervin Trashi ka blerë nga shtetasi L. Y. automjetin tip “Nissan”, me targa ***, në shumën 200.000 lekë. Në DPV/2007 subjekti e ka deklaruar blerjen e automjetit në shumën 200.000 lekë.

- Sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 19.3.2008, rezulton se shtetasi Ervin Trashi i ka shitur automjetin shtetasit T. M. në shumën 300.000 lekë. Në DPV/2008, subjekti e ka deklaruar shitjen e automjetit në shumën 300.000 lekë.

- Subjekti, i pyetur për blerjen në shumën 200.000 lekë dhe faktin që e ka shitur pas 5 muajve në vlerën 300.000 lekë, si dhe për dokumentacionin mbi pagimin e tatimit mbi të ardhurat nga shitja e këtij automjeti, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, nuk ka dhënë ndonjë shpjegim bindës.

Gjithashtu, deklaroi se nuk i kujtohet procedura për pagimin e tatimit, si dhe nuk paraqiti dokument provues për pagimin e tij. Meqenëse subjekti nuk ka arritur të provojë pagesën e tatimit mbi të ardhurat nga shitja³⁶, vlera e shitjes së automjetit është konsideruar e barabartë me vlerën e blerjes dhe shuma 200.000 lekë e përfituar nga shitja është përfshirë si e ardhur në analizën financiare të vitit 2008.

58. Në lidhje me burimin e krijimit, subjekti nuk e ka deklaruar burimin e krijimit të këtij automjeti në deklaratën *Vetting*, por në DPV/2007 ka specifikuar: “*Të ardhura të dhëna nga prindërit*”. Bazuar në analizën financiare të prindërve të subjektit deri në datën kur subjekti është emëruar në detyrë, duket se prindërit e tij nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të dhuruar shumën 200.000 lekë në datën 15.10.2007, e cila është 10 ditë pas emërimit të subjektit.

59. Në përfundim të hetimit administrativ u konstatua se në deklaratën *Vetting* subjekti nuk ka deklaruar burimin e krijimit të kësaj pasurie sipas ligjit, si dhe nuk justifikohet blerja e automjetit me të ardhura të ligjshme. Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të vërtetuar të kundërtën e këtyre konstatimeve.

60. Në parashtrimet e datës 5.11.2021, sipas subjektit, mosdeklarimi i burimit të krijimit të pasurisë në deklaratën *Vetting* është një pasaktësi e paqëllimtë, pasi në deklaratat e mëparshme është deklaruar burimi si të ardhura nga prindërit, duke argumentuar dhe me faktin se kjo pasuri nuk ka ekzistuar në kohën e përpilimit të deklaratës *Vetting*. Gjithashtu, subjekti nuk ka provuar të kundërtën e barrës së provës në lidhje me të ardhurat e ligjshme të prindërve që kanë shërbyer për blerjen e këtij automjeti, e megjithatë, meqenëse të ardhurat janë dhuratë nga prindërit dhe janë krijuar prej tyre para fillimit të detyrës së subjektit (automjeti është blerë më 15.10.2007, ose 10 ditë pas emërimit në detyrë të tij dhe është deklaruar në DPV/2007 me burim të ardhura nga prindërit), mungesa e fondeve për blerjen e automjetit, nuk përbën shkak për penalizimin e subjektit.

³⁴Shihni shkresën nr. *** prot., datë 11.5.2020, të DPSHTRR-së, në dosjen e Komisionit nr. 31 në dosjen ILDKPKI-së.

³⁵Shihni anekset 4/4 dhe 4/5 në dosjen ILDKPKI-së.

³⁶Në bazë të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, shitësi i automjetit duhet të paguajë mbi diferencën e çmimit të shitjes me atë të blerjes.

Në lidhje më shitjen e këtij automjeti në vitin 2009, në parashtrimet e tij, subjekti ka kundërshtuar se të ardhurat nga kjo shitje duhet të konsiderohen në vlerën 300.000 lekë dhe jo 200.000 lekë, aq sa çmimi i blerjes, sikundër është konsideruar nga Komisioni në rezultatet e hetimit. Subjekti sjell në vëmendje një bazë të gjerë ligjore³⁷ duke sqaruar se nga interpretimi i të gjitha parashikimeve ligjore për pagesën e tatimit mbi të ardhurat nga shitja e automjeteve, rezulton se e ardhura e përfituar si fitim midis çmimit të shitjes dhe të blerjes së automjeteve nuk është e ardhur e tatueshme dhe në legjislacionin e kohës nuk ka pasur procedurë të përcaktuar për mbledhjen e këtij tatimi, në këto kushte ai nuk ka pasur detyrim ligjor për pagesën e ndonjë detyrimi tatimor për këtë të ardhur. Ky pretendim nuk qëndron pasi subjekti nuk ka provuar se ka paguar tatim mbi fitimin e krijuar nga shitja e automjetit³⁸ dhe, për këtë shkak, si e ardhur nga shitja duhet të konsiderohet shuma 200.000 lekë, ashtu sikurse ishte konsideruar në analizën e dërguar me rezultatet e hetimit administrativ.

Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar pasurinë:

61. *Automjet tip “Nissan Primera”. Kontrata e shitjes nr. ***; datë 9.3.2008, redaktuar para noteres G. N. - Lushnjë. Vlera: 300.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %. Trajtuar më sipër.*

62. Në rubrikën detyrime financiare të deklaratës *Vetting*,

subjekti ka deklaruar: (1) Kontratë kredie bankare nr. ***, datë 29.9.2008. Qëllimi për blerje apartamenti në O., Vlorë. Shuma 20.000 euro me interes 6.5%/vit, afati 15 vjet, kësti mujor 176 euro. Fillon në datën 2.10.2008 dhe mbaron më 2.10.2023. Kredia është shlyer totalisht në masën 15.575 euro, para afatit në datën 28.11.2011³⁹. Kjo kredi është trajtuar në paragrafin 35 të vendimit; (2) Kontratë huaje nr. ***, datë 25.1.2011. Shuma e detyrimit në masën 1.800.000 lekë. Kjo shumë jepet me qëllim shlyerjen e kontratës së kredisë bankare nr. ***, datë 29.9.2008. Afati maksimal i përmbushjes së detyrimit për 10 vjet, pa interes. Shlyer plotësisht detyrimi në dhjetor të vitit 2015. Kjo hua është trajtuar në paragrafin 37 të vendimit.

Në deklaratën *Vetting*, babai i subjektit⁴⁰ ka deklaruar pasurinë:

63. *Shtëpi banimi nr. pasurie ***, z. k. ***, sip. 220 m², numri i kateve 3. Adresa: lagjja “L. Dh.”, rruga “H. S.” Lushnjë. Kjo banesë është ndërtuar para vitit 2006, vërtetuar nga formulari i vetëdeklarimit të legalizimit të objektit datë 6.9.2006, pranë njësisë së Qeverisjes Vendore Lushnjë. Me kontratën nr. ***, datë 4.1.2013 ka kaluar në pronësi parcela ndërtimore. Objekti është legalizuar me lejen e legalizimit nr. ***, datë 31.3.2013, lëshuar nga ALUIZNI dega Lushnjë. Pjesa takuese: 50%. Nuk është deklaruar sipërfaqja, vlera dhe burimi financiar.*

ILDKPKI-ja, për këtë pasuri, ka konstatuar: (i) pasaktësi në deklaratën e pasurisë *Vetting*, pasi nuk është deklaruar sipërfaqja, vlera dhe burimi financiar për objektin e banimit 3 kate me sip. 162.5 m² dhe sip. totale 554.6 m², në lagjen “L. Dh.” Lushnjë; (ii) mungesë dokumentacioni justifikues, si preventiv/situacion punimesh për vlerën e shpenzuar të objektit 3 kate, me sip. 554.6 m² në Lushnjë, në emrin e shtetasit A. T. (babai i subjektit). Rrjedhimisht mbetet i paqartë burimi financiar i përdorur nga prindërit për ndërtimin e kësaj banese.

³⁷Shihni paragrafët 83 - 92 të parashtrimeve të subjektit.

³⁸Referuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar.

³⁹Marrja e kredisë në bankë është trajtuar në paragrafët 29-32 dhe shlyerja e kredisë në paragrafin 35.

⁴⁰Babai i subjektit të rivlerësimit, z. A. T., i cili në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* është pjesë përbërëse e familjes së subjektit.

Hetimi i Komisionit për këtë pasuri

64. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar si adresë vendbanimi adresën e kësaj pasurie, por nuk e ka deklaruar këtë pasuri si pasuri në përdorim sipas pikës 11, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, i cili përveç detyrimit për deklarimin e pasurive në përdorim, parashikon edhe detyrimin e deklarimit të burimit të krijimit të këtyre pasurive. Gjithashtu, në të gjitha DPV-të e ka deklaruar adresën e kësaj pasurie si adresë vendbanimi. Në vijim, gjatë procesit, subjekti ka pohuar se ka banuar gjatë gjithë kohës në pasurinë e sipërpërmendur në pronësi të babait të tij. Në këto rrethana është bërë e domosdoshme kryerja e veprimeve hetimore me qëllim evidentimin e lidhjeve të subjektit me këtë pasuri si: vërtetimi i periudhave kur janë kryer investimet në objekt, vlerës së investimeve dhe burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për investimin nga prindërit apo investimeve të mundshme të kryera nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës që ka qenë në detyrë.

Në lidhje me origjinën dhe mënyrën e krijimit të pasurisë

65. Nga aktet në dosje⁴¹, rezulton se në rend kronologjik janë kryer veprimet si vijojnë:

65.1. Sipas vetëdeklarimit të datës 6.9.2006, deklaruesi A. T. deklaroi objektin banesë, në lagjen “L. Dh.”, Lushnjë, ndërtuar më 10.9.2000, sipërfaqe e zënë 280 m², sipërfaqe ndërtimi 165 m², 3 kate mbi tokë.

65.2 Sipas procesverbal-konstatimit nga Drejtoria Rajonale ALUIZNI Qarku Fier, të datës 5.1.2009, rezulton se ndërtesa ka 3 kate me sipërfaqe të përgjithshme 554.6 m². Bashkëlidhur këtij procesverbal-konstatimi ndodhen edhe planimetritë përkatëse të secilit kat.

65.3 Sipas aktekspertimit të datës 4.1.2013 përcaktohet se objekti është inspektuar në datën 29.12.2012, shoqëruar me foto të ndërtesës ku rezulton se ndërtesa është 3 kate.

65.4 Nga dokumentet e dosjes të përcjella nga ZVRPP-ja Lushnjë dhe Drejtoria ALUIZNI Lushnjë në lidhje me këtë objekt, rezulton se:

- Në formularët e pagesës së parcelës ndërtimore në shumën 100.800 lekë dhe në bono privatizimi në vlerën 220.000 lekë, të lëshuara më 11.6.2010, numri i kateve është përcaktuar në dy.

- Në VKM-në nr. ***⁴², datë 18.11.2009, “Për kalimin e pronësisë së disa parcelave ndërtimore në favor të poseduesve të objekteve informale” shtetasi A. T. figuron në listën emërore për kalim pronësie të parcelës ndërtimore, ku numri i kateve është shënuar në dy.

- Në formularin për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, lëshuar më 22.6.2010, sipërfaqja e ndërtimit është në 347.1 m² vetëm për dy kate, katin përdhës dhe katin e parë, ku vlera e investimit është përlllogaritur 9.564.341 lekë, për të cilën është paguar taksa 0.5% në shumën 47.822 lekë.

- Në formularin për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, lëshuar më 4.1.2013, sipërfaqja e ndërtimit është në 554.6 m², për tri kate, ku vlera e investimit është përlllogaritur 6.116.960 lekë (për diferencën e sipërfaqeve 554.6 m²- 3471 m² = 207.5 m²) për të cilën është paguar taksa 0.5 %, në shumën 30,597 lekë.

⁴¹Shihni aktet në aneksin 4/9 dhe shkresën nr. *** prot., datë 8.4.2019, të ZVRPP-së Lushnjë dhe dokumentet bashkëngjitur, aneksi 29 dhe shkresën nr. *** prot., datë 28.8.2017, të ALUIZNI-t Lushnjë dhe dokumentet bashkëngjitur, aneksi 30 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁴²Shihni Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë f. 8030, nr. 180, datë 24.12.2009.

65.5 Me kontratë nr. ***, datë 4.1.2013, me palë shitës Drejtoria e ALUIZNI-t Lushnjë dhe blerës A. H. T., ka kaluar në pronësi të shtetasit A. H. T. parcela ndërtimore me sip. 220.8 m², me nr. pasurie ***, z. k. ***.

65.6. Sipas lejes së legalizimit nr. ***, datë 31.1.2013, rezulton godinë banimi 3 kate, në emër të shtetasit A. H. T., Lushnjë, nr. pasurie ***, sipërfaqe e parcelës 220.8 m², sipërfaqja e ndërtimit 162.5 m², sipërfaqe totale 554.6 m²⁴³.

65.7. Sipas vërtetimit nga dokumentet hipotekore në datën 22.2.13 dhe kartelës së pasurisë, vërtetohet se në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 22.2.13, figuron në pronësi të shtetasit A. H. T., pasuria nr. ***, me sip. 220.8 m² në adresën e llojit truall + ndërtesë (shtëpi banimi 3 kate: kati përdhës = 162.5 m², sip. kati i parë =194.5 m², sip. kati i dytë =197.6 m².

65.8. FSHU-ja konfirmon⁴⁴ se me gjeneralitetet A. T. identifikohet një abonent në instancën Lushnjë, L. Dh.. Ndërsa UK Lushnjë⁴⁵ ka konfirmuar se shtetasi A. T. ka lidhur kontratë, si dhe ka bashkëngjitur informacion për pagesat për periudhën gusht 2006 – gusht 2021, e cila përputhet me të dhënat e librezës së paraqitur nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 2.

Në lidhje me periudhën e ndërtimit, vlerën e investimeve dhe burimin e krijimit

66. Sa i takon periudhës së ndërtimit të kësaj pasurie në deklaratën *Vetting*, babai i subjektit A. T. ka deklaruar se kjo banesë me tri kate është ndërtuar para vitit 2006, ndërkohë që, në formularin e vetëdeklarimit të datës 6.9.2006, shkruhet “*viti i ndërtimit 10.9.2000*”. Por, nga të dhënat e administruara gjatë hetimit administrativ, rezultuan të dhëna të ndryshme nga ky deklaram. Konkretisht:

66.1. Nga ortofotoja e vitit 2007 në faqen zyrtare GJEOPORTAL⁴⁶, duket qartë se ndërtesa është e ulët dhe pa çati të pjerrët, ndërsa në vitin 2015, ndërtesa duket më e lartë dhe me çati të pjerrët, duke lënë të kuptohet që janë kryer investime pas vitit 2007 deri në vitin 2015.

66.2 Sipas informacionit të sjellë nga ASIG⁴⁷ rezulton se: (i) lartësia e banesës në vitin 2007 është më e ulët se ajo e vitit 2015; (ii) në vitin 2007 nuk ka çati ndërsa në vitin 2015 ka çati, fakte që tregojnë se kati i tretë/papafingo është ndërtuar pas vitit 2007 deri në vitin 2015.

66.3. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti deklaroi se ndërtimi i katit të parë ka përfunduar në vitin 1997 dhe ka banuar në këtë kat së bashku me prindërit deri në vitin 2006, ndërsa nga ky vit banon vëllai i tij me familjen. Ndërtimi i katit të dytë ka përfunduar rreth viteve 2000 - 2001 dhe nuk është përdorur deri në vitin 2006, ndërsa nga ky vit në këtë kat jeton subjekti me prindërit e tij. Sipas subjektit, papafingoja mbi katin e dytë ka përfunduar rreth vitit 2005 - 2006, e cila përdoret si dhomë gjumi dhe dhomë fëmijësh prej tij dhe familjes së tij⁴⁸. Ky deklaram i subjektit jo vetëm është në kuadër deklarativ, pasi nuk paraqiti asnjë provë që vërteton investimet e deklaruara në periudhat përkatëse, por bie në kundërshtim me provat dhe

⁴³Shihni shkresën nr. *** prot., datë 22.5.2020, të ASHK-së Drejtoria e Përgjithshme, konfirmon në emër të A. H. T. nr. leje ***, datë 31.1.2013 godinë banimi 3 kate Lushnjë, në dosjen e Komisionit dhe aneks ***, shkresë nr. *** prot., datë 28.8.2017 Drejtoria e ALUIZNI-t Lushnjë, shoqëruar me kopje të praktikës, në dosjen ILDKPKI-së.

⁴⁴Shihni shkresat nr. *** prot., datë 14.5.2020 dhe nr. *** prot., datë 21.9.2021, të FSHU-së, në dosjen e Komisionit.

⁴⁵Shihni shkresë nr. *** prot., datë 16.9.2021, të UK sh. a. Lushnjë dhe librezë uji në dosjen e Komisionit.

⁴⁶www.asig.gov.al i cili jep informacion të fotografimit ajror të vitit 2015 pas atij të vitit 2007.

⁴⁷Shihni shkresat nr. *** port., datë 14.9.2021 dhe nr. ***, datë 22.9.2021, të Autoritetit Shtetëror të Informacionit Gjeohapësinor, në dosjen e Komisionit.

⁴⁸Subjekti është martuar në vitin 2019.

faktet e përcaktuara në paragrafët 66.1 dhe 66.2 më sipër, si dhe me formularin e vetëdeklarimit datë 6.9.2006, në të cilin shkruhet *viti i ndërtimit 10.9.2000*.

Në këto rrethana, ndërtimi i katit të tretë/papafingo, në rezultatet e hetimit administrativ është konsideruar të jetë kryer pas datës 14.4.2007 (arsyetuar hollësisht në vijim).

67. Në lidhje me vlerën e investimeve, në mungesë të një informacioni për sasinë e punimeve të kryera çdo vit dhe vlerën e investimit të kryer, Komisioni është bazuar në çmimet e ndërtimit sipas EKB-së, pasqyruar në tabelën më poshtë, duke ndjekur këtë metodologji:

67.1. Çmimet e ndërtimit për metër katror për sipërfaqe ndërtimi, në qytetin e Lushnjës janë bazuar në Udhëzimet e Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kostos mesatare të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave”, për çdo vit respektiv.

67.2 Koha e ndërtimit është marrë e mirëqenë ashtu sikurse është deklaruar nga subjekti për dy katet e para: kati 1-rë gjatë viteve 1993 – 1997 dhe kati i 2-të gjatë viteve 2000 – 2001. Ndërsa, kati i tretë është konsideruar të jetë ndërtuar nga data 14.4.2007, që është data e fotografimit satelitor sipas të dhënave të ASIG-ut, sipas të cilit banesa figuron me dy kate, deri më 5.1.2009 që është data e procesverbal-konstatimit të lëshuar nga Drejtoria Rajonale ALUIZNI Qarku Fier, ku rezulton se ndërtesa ka 3 kate të përfunduara.

67.3. Pavarësisht se në dosjen e ILDKPKI-së dhe në atë të Komisionit janë administruar disa të dhëna shkresore, të cilat paraqesin gjendjen e objektit në vitin 2010 me dy kate (pasqyruar në paragrafin 65.4 të vendimit), Komisioni ka vlerësuar që procesverbal-konstatimi i datës 5.1.2009 është dokumenti tekniko-ligjor me i plotë dhe më i saktë, pasi përcakton se në datën e nënshkrimit të tij nga dy punonjës të autorizuar të DR ALUIZNI Qarku Fier, kanë qenë të ndërtuara tri kate, duke specifikuar sipërfaqen e çdo kati dhe duke bashkëlidhur planimetritë e kateve.

67.4 Volumi i ndërtimit për çdo vit është ndarë ndër vite, bazuar në logjikën e zhvillimit të një projekti ndërtues.

67.5 Vlera e investimit në total dhe për çdo kat është përlllogaritur bazuar në çmimet e EKB-së për metër katror për sipërfaqe ndërtimi, në qytetin e Lushnjës, sikurse është treguar në tabelën vijuese.

Baza Ligjore	Viti	Çmimi për m ² sipërfaqe ndërtimi	Pjesa e ndërtuar çdo vit	Sipërfaqe e ndërtuar sipas viteve	Vlera e reduktuar me 74,24% ⁴⁹	Vlera e kateve (lekë)
Vendim nr. ***, datë 9.12.1996	1994	13 127	1/2	81.25	791 778	Kati 1 1 712 755
Vendim nr. ***, datë 5.1.1998	1995	13 127	1/6	27.08	263 926	
	1996	16 340	1/6	27.08	328 525	
Vendim nr. ***, datë 14.7.2000	1997	16 340	1/6	27.08	328 525	Kati 2 3 315 534
	2000	22 303	1/2	97.25	1 610 155	
Udhëzim nr. ***, datë	2001	23 622	1/2	97.25	1 705 379	
Udhëzim nr. ***, datë 4.4.2007	2007	25 526	1/2	98.80	1 872 210	

⁴⁹Vlera e investimit për çdo vit është reduktuar në masën 25% pasi janë marrë në konsideratë deklaratimet e subjektit, sikurse është trajtuar në çështjen 69 të këtij vendimi. Ky reduktim është bazuar në vendimin nr. 15, datë 17.7.2019, paragrafi 33 i Kolegjit.

Udhëzim nr. ***, datë	2008	27 555	1/2	98.80	2 021 027	Kati 3
Totali i investimit në lekë						8 921 526

Siç vërehet në tabelë, vlera e investimit në total është 8.921.526 lekë, nga të cilat kati i parë 1.712.755 lekë, kati i dytë 3.315.534 lekë dhe kati i tretë 3.893.237 lekë.

68. Sa i takon burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për ndërtimin e objektit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se kjo banesë është ndërtuar me kursime familjare që vijnë nga më shumë se 50 vjet punë dhe sakrificë të kryer prej prindërve të tij dhe një pjesë e mirë e të ardhurave është kontribut i punës së lirë (zanateve) të prindërve të tij. Subjekti gjithashtu ka sqaruar se banesa është ndërtuar, ndër vite, me punën e krahut të babait të tij dhe ndihmën e të afërmeve të tjerë, pasi babai i subjektit është murator pavarësisht se institucionet shtetërore nuk kanë asnjë të dhënë në lidhje me këtë fakt. Subjekti nuk paraqiti dokumente të tjera shpresore në lidhje me të ardhura të familjarëve, përveç atyre të administruara nga Komisioni.

69. Nga analiza financiare pasqyruar në tabelën më poshtë të kryer në përfundim të hetimit administrativ, duket se subjekti dhe familja e tij nuk kanë justifikuar ndërtimin e katit të parë dhe të dytë me të ardhura të ligjshme, fakt i cili nuk afekton analizën financiare të subjektit dhe as nuk rëndon pozitën e tij për shkak se investimet e këtyre kateve janë kryer përpara se të emërohej në detyrë. Sa i takon ndërtimit të katit të tretë, subjekti dhe familja e tij nuk justifikojnë vlerën e investimit me të ardhura të ligjshme për periudhën 5.10.2007 – 31.12.2008, periudhë gjatë së cilës subjekti ka qenë në detyrë, për shkak të një balance negative në total -2.578.107 lekë.

Përshkrimi	1994 – 5.10.2007	5.10.2007– 31.12.2007	1.1.2008– 31.12.2008
Pasuri	6 283 340	825 083	4 751 871
Shtëpi banimi 3 kate, kati përdhes V.1993 – 1997 sip.162.5 m ²	1 712 755		
Shtëpi banimi 3 kate kati 2 - vitet 2000 - 2001 sip. 194.5 m ²	3 315 534		
Shtëpi banimi 3 kate kati 3 – periudha 14.4.2007 – 2008	1 248 140	624 070	2 021 027
Automjet tip “Nisan Primera” me targa ***		200 000	-200 000
Apartament sip. 56 m ² , O., Vlorë	0		2 956 380
<i>Shtesa/pakësime likuiditetesh</i>	<i>6 910</i>	<i>1013</i>	<i>-25 536</i>
Të ardhura	4 219 962	281 195	3 709 954
Të ardhura nga pagat subjekti	841 725	165 644	797 435
Të ardhura nga pagat babai (nga Drejtorja e Hekurudhave)	1 836 747	49 172	202 021
Të ardhura nga pagat nëna	1 541 490	66 379	246 848
Marrë nga BNG-ja 20.000 euro			2 463 650
Shpenzime	3 194 246	135 883	656 419
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së familja, 3 persona.	3 194 246	102 465	409 860
Shpenzime transporti		33 418	169 400
Paguar këste kredie bankare			43 161
Shpenzime kredie			33 998
Mundësia për kursime	-5 257 624	-679 771	-1 698 336

Në këtë analizë, janë përfshirë të ardhurat e dokumentuara të familjes (të prindërve dhe subjektit pasi filloi shkollën e magistraturës në vitin 2005) si dhe shpenzimet e tyre që nga viti

1994 deri në 31.12. 2008, kur ka përfunduar ndertimi i banesës⁵⁰. Meqenëse subjekti ka jetuar me prindërit e tij, si para edhe pas emërimit në detyrë, është analizuar së bashku me ta. Nuk janë përfshirë të ardhura nga toka bujqësore, çështje e trajtuar në paragrafin 84 të vendimit. Shpenzimet e jetesës janë përlllogaritur si vijon: për periudhën 1994 – 1999 janë përlllogaritur si 66% e të ardhurave familjare, ndërsa nga viti 2000 e në vijim për 3 persona, dy prindërit dhe subjekti⁵¹.

70. Në përfundim të hetimit administrativ, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të vërtetuar të kundërtën e konstatimeve në lidhje me këtë pasuri, duket se: (i) ka mospërputhje në deklaratimet e subjektit dhe babait të tij sipas të cilave shtëpia është ndërtuar para vitit 2006, me fakte dhe prova të administruara gjatë procesit, sipas të cilave deri në vitin 2006 ishte ndërtuar vetëm kati i parë dhe i dytë i banesës, ndërsa kati i tretë është ndërtuar pas vitit 2006; (ii) subjekti dhe familja e tij nuk kanë justifikuar me të ardhura të ligjshme ndërtimin e katit të tretë, për shkak të një balance negative prej 2.578.107 lekësh.

71. Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe arsyetimi i Komisionit mbi faktet dhe ligjin e zbatueshëm

71.1 Në lidhje me mospërputhjen e deklaratimeve të subjektit dhe babait të tij sa i takon investimeve në banesë para vitit 2006, me provat e administruara gjatë hetimit administrativ sipas të cilave kati i tretë është ndërtuar në vitet 2007 – 2009, në parashtrimet e tij, duke pranuar faktin që ndërtimi i katit të tretë ka përfunduar gjatë vitit 2007, subjekti në mënyrë të paqartë ka deklaruar se: *“Duke qenë se personi i lidhur i ka bashkëngjitur deklaratës aktet zyrtare të legalizimit të kësaj pasurie dhe të regjistrimit të saj, në të cilat gjen pasqyrim sipërfaqja e secilit prej kateve dhe karakteristikat e tjera të sendit, për këtë shkak ka vlerësuar të mos ngarkojë formularin. Babai im e ka për herë të parë që plotëson deklaratën dhe mund të kuptohen gabimet të mundshme të tij. Për të shmangur gabimet në përcaktime, sa kohë që ka dorëzuar dhe aktet e legalizimit dhe të regjistrimit, ka vlerësuar të panevojshme detajimet”*. Gjithashtu, subjekti i është referuar vendimit nr. 14/2021, të Kolegjit, ndërkohë që rasti i trajtuar nga ky vendim nuk është i njëjtë me atë të subjektit të rivlerësimit, pasi ka të bëjë me pasuri në proces legalizimi dhe dokumentacioni bashkëngjitur deklaratës *Vetting* është gjetur në përputhje me faktet. Në rastin konkret kemi të bëjmë me një pasuri tashmë të regjistruar dhe në dokumentacionin bashkëngjitur deklaratës *Vetting* nuk pasqyrohet vlera e ndërtesës/investimeve dhe, për më tepër, gjatë hetimit administrativ u vërtetuan fakte që vijnë në kundërshtim me deklarin e vitit të ndërtimit të objektit nga subjekti dhe babai i tij. Në këto kushte, argumentet e subjektit u çmuan jobindëse dhe të pamjaftueshme për të justifikuar mospërputhjet në deklaratime.

71.2 Pasi i kaloi barra e provës, subjekti, i ndodhur përpara faktit që kati i tretë papafingo është ndërtuar në periudhën pas datës 14.4.2007, që është data e fotografimit satelitor sipas të dhënave të ASIG-ut, ku banesa figuron me dy kate, për herë të parë në parashtrime pranoi faktin se kati i tretë i banesës/papafingo është kryer tërësisht në vitin 2007, por sipas subjektit, përpara se të fillonte të ushtronte detyrën që është data 5.10.2007. Për të vërtetuar këtë pretendim, subjekti paraqiti si provë shkresore deklaratën me vërtetim nënshkrimi nr. *** rep., datë 28.10.2021, të shtetasit M. H., i regjistruar si person fizik në fushën e ndërtimit, i cili deklaroi se është kontraktuar në gusht të vitit 2007 për ndërtimin e çatisë, e cila ka përfunduar brenda këtij muaji. Bashkëngjitur kësaj deklarate është një faturë e thjeshtë tatimore nr. ***, datë 2.8.2007, sipas së cilës rezultojnë punime për ndërtim çatie kati III, materiale + punëtor

⁵⁰ Referuar procesverbal-konstatimit të datës 5.1.2009.

⁵¹ Në këtë analizë nuk është përfshirë vëllai i subjektit G. T., pasi për të nuk ka asnjë të dhënë nëse ai ka punuar, etj.

me sip. 170 m², në total në shumën 510.000 lekë. Bazuar në këtë dokument, subjekti ka kundërshtuar analizën financiare dhe kërkon nga Komisioni që vlera e ndërtimit të katit të tretë papafingo të mos përfshihet në analizën financiare gjatë periudhës që ka qenë në detyrë, por përpara se të fillonte detyrën.

71.3. Ky pretendim i ri i subjektit vjen në kundërshtim me deklaratimet e tij në përgjigje të pyetësorit nr. 2, sipas të cilave papafingoja mbi katin e dytë ka përfunduar rreth viteve 2005 - 2006, si dhe me deklarin e babait të tij se banesa ishte ndërtuar para vitit 2006 (sipas formularit të vetëdeklarimit në vitin 2000). I pyetur gjatë seancës dëgjimore nëse faturën nr. ***, datë 2.8.2007 e kanë disponuar prindërit e tij apo personi që kishte ndërtuar çatinë, subjekti u përgjigj se këtë faturë e kanë pasur prindërit në shtëpi, deklarim që duket i pabesueshëm për sa kohë subjekti nuk e ka paraqitur këtë faturë kur është pyetur gjatë hetimit administrativ në lidhje me periudhat e investimeve në pasurinë objekt shqyrtimi, ndërkohë që të dhënat e saj vijjnë në kundërshtim me deklaratimet e babait të subjektit në deklaratën *Vetting* sipas të cilave kjo banesë është ndërtuar para vitit 2006. Në këto rrethana, deklarata e shtetasit M. H. dhe fatura e thjeshtë tatimore bashkëlidhur me të, të paraqitura për herë të parë në parashtrime pas kalimit të barrës së provës, jo vetëm që nuk mund të konsiderohen si një prova shkresore të besueshme për të vërtetuar faktin që ndërtimi i çatisë ka përfunduar në datën 2.8.2007, por vlerësohen nga Komisioni si përpjekje të subjektit për të justifikuar përfundimin e katit të tretë papafingo brenda periudhës nga data 14.4.2007 që është data e fotografimit satelitor, deri në datën 5.10.2007, që është data e emërimit të subjektit në detyrë, pra jashtë periudhës që ai ka qenë në detyrë.

Për rrjedhojë, në analizën financiare përfundimtare, vlera e investimit të kryer për ndërtimin e katit të 3-të të banesës, është konsideruar si shpenzim gjatë periudhës që subjekti ka qenë në detyrë, ashtu sikurse ka qenë në përfundim të hetimit administrativ.

71.4 Sa i takon mungesës së justifikimit me të ardhura të ligjshme për ndërtimin e katit të tretë, për shkak të një balance negative prej 2.578.107 lekësh, subjekti nuk ka dhënë asnjë shpjegim dhe nuk paraqiti prova shkresore për të kundërshtuar barrën e provës, qëndrim i mbajtur për shkak të konsiderimit të ndërtimit të katit të tretë përpara fillimit të detyrës.

71.5. Në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, Komisioni vlerësoi se subjekti nuk arriti të kundërshtojë barrën e provës në lidhje me ndërtimin e katit të tretë/papafingo gjatë kohës që ka qenë në detyrë. Për këtë pasuri, për të cilën mungon të jenë kryer deklarime si pasuri në përdorim në deklaratën *Vetting*, sipas kërkesave të ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon detyrimin e subjekteve që të deklarojnë edhe të drejtat reale të pasurive në përdorim, vlerën dhe burimin e krijimit të tyre (ndonëse është deklaruar si adrese banimi), subjekti ka kryer deklarime të pasakta dhe kontradiktore, si dhe nuk ka justifikuar me të ardhura të ligjshme ndërtimin e katit të tretë papafingo gjatë periudhës që ka qenë në detyrë. Për rrjedhojë ka kryer deklarime të pamjaftueshme, të cilat sipas nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2015 përbejnë shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

Në deklaratën *Vetting*, babai i subjektit ka deklaruar pasurinë:

72. “Akti i marrjes së tokës në përdorim nr. ***, datë 6.7.1993, për sipërfaqen prej 20.400 m² tokë arë, lëshuar në emër të H. T.. Vlera e papërcaktuar. Pjesa takuese: 1/8 pjesë. Me dëshminë e trashëgimisë nr. ***, datë 6.3.2001, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, vërtetohet fakti se A. T. është i biri dhe trashëgon 1/8 pjesë të pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme të trashëgimlënësit. Respektivisht nga sipërfaqja prej 20.400 m², posedon sipërfaqen prej 6.000 m².”

73. Gjatë hetimit administrativ ka rezultuar⁵² se: (i) sipas aktit të marrjes së tokës në përdorim nr. ***, datë 6.7.1993, familja e shtetasit H. T. ka përfituar sipërfaqen e tokës 20.394 m² tokë arë dhe 312 m² rrugë, pra në total 20.706 m²; (ii) me dëshminë e trashëgimisë nr. ***, datë 6.3.2001, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, shtetasi A. T. ka përfituar 1/8 pjesë të trashëgimisë së trashëgimlënësit babait të tij H. T.; (iii) në deklaratën *Vetting* shtetasi A. T. ka deklaruar se nga sipërfaqja 20.400 m² tokë arë zotëron 6.000 m².

Nuk ka të dhëna për lidhje të subjektit me këtë pasuri dhe as investime të kryera prej tij.

Në deklaratën *Vetting*, babai i subjektit ka deklaruar pasurinë:

74. “*Gjendje cash 1.000.000 lekë. Pjesa takuese: 50 %*”. Nuk është deklaruar burimi i krijimit. I pyetur për burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për krijimin e kësaj shume, subjekti, në përgjigje të pyetësorit nr. 2 ka deklaruar: “*Nga biseda me prindërit e mi më kanë informuar se kanë gjendje cash shumën 1.000.000 lekë të kursyer ndër vite gjatë gjithë jetës së tyre. Të ardhurat janë nga burime të ligjshme. Këtë fakt e kam sqaruar edhe në pyetjen nr. 4*”, si dhe nuk ka paraqitur ndonjë dokument shkresor.

75. Komisioni ka kryer analizën financiare të prindërve të subjektit dhe prindërve të tij në vitin 2016 për të parë mundësinë financiare të tyre për krijimin e likuiditetit *cash* në shumën 1.000.000 lekë, të deklaruar në deklaratën *Vetting*. Në këtë analizë janë përfshirë të ardhurat e dokumentuara nga pagat e subjektit në shumën 1.122.703 dhe nga pagat dhe pensionet e prindërve të tij në shumën 403.040 lekë. Shpenzimet e jetesës janë përlogaritur duke përdorur standardin e ILDKPKI-së për 3 persona. Meqenëse prindërit e subjektit nuk janë subjekte deklaruese, kursimet e tyre janë përlogaritur duke përdorur metodologjinë kumulative. Kështu, diferenca e mbetur nga të ardhurat e tyre minus shpenzimet e jetesës për të dy prindërit e subjektit, është kursyer në mënyrë kumulative nga viti 2009⁵³ deri në fund të vitit 2016, duke u përfshirë si e ardhur e akumuluar në shumën 595.011 lekë.

76. Sipas kësaj analize, pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën vijuese, shtetasi A. T. dhe bashkëshortja e tij, kanë pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për krijimin e shumës 1.000.000 lekë deri në deklaratën *Vetting*.

Përshkrimi	Viti 2016
Pasuri	996 782
<i>Ndryshim likuiditetesh</i>	996 782
<i>Gjendje cash e krijuar nga prindërit</i>	1 000 000
Likuiditete të familjes	400 946
Të ardhura	2 120 754
Të ardhura nga pagat subjekti	1 122 703
Të ardhura nga pagat dhe pensioni babai	171 625
Të ardhura nga pagat dhe pensioni nëna	231 415
Të ardhura të akumuluar nga kursimet e pagave të prindërve 2009 - 2016	595 011
Shpenzime	1 007 020
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI-së për 3 persona	705 276
Shpenzime udhëtimi sipas sistemit <i>TIMS</i>	132 344
Shpenzime transporti	169 400
Mundësia për kursime	116 952

⁵²Shihni aktet në aneksin *** dhe shkresën nr. *** prot., datë 8.4.2019, të ZVRPP-së Lushnjë dhe dokumentet bashkëngjitur, aneks 29 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁵³Deri në vitin 2008 këto kursime janë përdorur si burim për ndërtimin e katit të 3-të të banesës.

77. Në përfundim të hetimit administrativ u konstatua se personi i lidhur A. T. nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* burimin e ligjshëm të likuiditetit *cash* prej 1.000.000 lekësh. Pasi subjektit i është kërkuar të japë sqarime në lidhje me këtë konstatim, me kalimin e barrës së provës, në parashtrimet e tij, subjekti nuk ka dhënë asnjë shpjegim. Vlen të theksohet se megjithëse analiza financiare e vitit 2016, e rishikuar, ndryshoi nga një balancë pozitive në një balancë negative, për shkak të përfshirjes së vlerës së automjetit me targa *** si pasuri e blerë në këtë vit, sikurse është trajtuar në paragrafin 54.6 të vendimit, konkluzioni se prindërit e subjektit kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e shumës 1.000.000 lekë nuk ndryshon⁵⁴.

78. Në deklaratën *Vetting*, nëna e subjektit, znj. Sh. G. T., ka plotësuar autorizimin për kontrollin e deklaratës së interesave, ku ka evidentuar se ka pasuri veçmas të regjistruar në emrin e saj dhe ka deklaruar të njëjtat pasuri si bashkëshorti i saj.

Konstatime të tjera

Në lidhje me përdorimin e një automjeti:

79. Në përgjigjet e pyetësorit nr. 1 subjekti ka deklaruar se ka pasur në përdorim në vitin 2011 automjetin e xhaxhait G. T., me targa *** (fillimisht ka qenë ***). Nga verifikimet në lidhje me këtë automjet, rezultoi se:

79.1 Nga të dhëna e sistemit *TIMS* rezulton se subjekti ka dalë nga pika kufitare Kakavijë nëntë herë me këtë automjet gjatë vitit 2011 dhe dy herë në vitin 2012. Sipas subjektit, arsyeja e udhëtimit ka qenë vajtja në Janinë për të blerë ilaçe për bashkëshorten e sëmurë të xhaxhait N. T., për shkak se subjekti në këtë periudhë ka punuar në Gjirokastrë (prill 2009 - nëntor 2011).

79.2 Sipas sistemit AMF subjekti rezulton si policëmbajtës përdorues për automjetin me targa ***, për periudhën 3.10.2010 - 2.10.2011.

79.3 Subjektit iu kërkuar sqarime në lidhje me arsyen e përdorimit të automjetit, duke paraqitur dokumenta provues që vërtetojnë përdorimin, fitimin e pronësisë së këtij automjeti, statusin aktual të tij, etj., si dhe të japë sqarime e dokumenta për burimin e ligjshëm të të ardhurave të shtetasve G. dhe N. T., që kanë shërbyer për blerjen e këtij automjeti. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2 ka deklaruar se mjeti *është përdorur prej tij me qëllim për të dalë jashtë shtetit në Greqi, në 4-5 raste në vitin 2011 dhe se nuk mban mend të ketë pasur akt përdorimi apo prokurë gjatë drejtimit të këtij automjeti. Gjithashtu ka deklaruar se ky automjet është përfutur me dhurim dhe se është shitur para disa vitesh.* Subjekti nuk paraqiti dokumente për të vërtetuar sa i është kërkuar nga Komisioni.

80. Me përfundimin e hetimit administrativ, për Komisionin mbeti e paqartë mënyra e fitimit të pronësisë së automjetit nga shtetasi G. T., mënyra e lejimit të përdorimit nga subjekti, statusi aktual i këtij automjeti dhe burimi i ligjshëm i të ardhurave të këtij shtetasi për blerjen e automjetit. Me qëllim heqjen e çdo dyshimi në lidhje me këtë automjet, me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektit i është kërkuar të vijojë të japë sqarime dhe dokumente në lidhje me këto konstatime.

⁵⁴Rezultati në fund të vitit 2016 është -433.048 lekë ndërsa automjeti i blerë në vlerën 600.000 lekë. Kështu, për të shmangur mbivendosjen e një balance negative konkludohet që ajo i atribuohet blerjes së automjetit.

81. Në parashtrimet e tij subjekti ka dhënë deklarime të pakta dhe, përgjithësisht, të njëjta me deklaratimet gjatë procesit të rivlerësimit duke pretenduar se qëllimi i përdorimit të automjetit kanë qenë daljet jashtë shtetit dhe se nuk ka qenë një përdorim i vazhdueshëm. Sipas subjektit, automjeti është shitur disa vjet më parë, shitje për të cilën xhaxhai nuk ka ruajtur dokumentacion dhe, për shkak se automjeti ka ndërruar pronësinë, nuk gjenerohen të dhënat në sistemin *e-albania*. Ndërsa në seancën dëgjimore, pasi është pyetur nëse kishte ndonjë informacion a dokument të ri në lidhje me këtë automjet, subjekti ka deklaruar se nuk ka mundur të marrë informacion, duke u mjaftuar në shpjegimet që i ka dhënë xhaxhai i tij. Po kështu, subjekti në seancën dëgjimore pretendoi se ka vënë në dispozicion të Komisionit një dokument që vërteton fitimin e pronësisë mbi këtë automjet, fakt që nuk rezultoi të jetë i vërtetë.

Gjithashtu, subjekti pretendoi se nuk e ka konceptuar që i është dhënë barrë prove në lidhje me këtë automjet dhe kjo ka qenë një arsye që ka dhënë vetëm sqarime dhe nuk ka paraqitur dokumenta. Përkundër sa pretendohet, subjektit i janë kërkuar në mënyrë të qartë sqarime dhe dokumente shkresore si gjatë hetimit administrativ⁵⁵ ashtu edhe me njoftimin e rezultateve të hetimit administrativ dhe qëndrimi i subjektit në secilin rast ka dëshmuar mungesën e çdo përpjekjeje të tij për të kërkuar informacion në lidhje me këtë mjet. Konkretisht, në aktin rezultate të hetimit administrativ, në faqen 23 të tij, është shkruar: *“Me përfundimin e hetimit administrativ, mbetet e paqartë mënyra e fitimit të pronësisë së mjetit nga shtetasi G. T., mënyra e lejimit nga ana e tij për përdorimin e mjetit nga subjekti, statusi aktual i këtij mjeti dhe burimi i ligjshëm i të ardhurave të këtij shtetasi për blerjen e mjetit. Me qëllim heqjen e çdo dyshimi në lidhje me këtë mjet, subjekti të vijojë të japë sqarime dhe dokumente në lidhje me këto konstatime”*.

Sa i takon pretendimit se për këtë mjet nuk i ka kaluar barrë prove dhe për këtë shkak nuk ka paraqitur dokumente, nga Komisioni vlerësohet si justifikim i mosveprimeve të subjektit në lidhje me sa i është kërkuar. Për më tepër, subjekti vjen në kundërshtim me qëndrimin e tij në një rast tjetër kur në rezultatet e hetimit administrativ i është kërkuar të japë sqarime dhe, në mbështetje të deklaratimeve të tij në parashtrime ka paraqitur dokumente shkresore⁵⁶. Gjithashtu, në kundërshtim me qëndrimin e mbajtur për automjetin objekt shqyrtimi, subjekti, duke iu përgjigjur kërkesave të Komisionit gjatë hetimit administrativ, ka dhënë shpjegime të detajuara dhe ka paraqitur një numër të konsiderueshëm aktesh shkresore në lidhje me një pasuri të paluajtshme që shtetasi G. dhe N. T., kanë vënë si garanci hipotekore për kredinë me vlerë 20.000 euro marrë prej subjektit në Bankën Kombëtare të Greqisë⁵⁷.

82. Në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, përtej çdo dyshimi, nuk u vërtetuan fakte dhe rrethana konkrete që të vërtetojnë a të hedhin dritë mbi dyshimet për një pronësi të mundshme të subjektit mbi këtë automjet. Por, referuar deklaratimeve të pakta dhe qëndrimit të subjektit gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, Komisioni çmoi se subjekti i është shmangur në mënyrë të përsëritur pyetjeve dhe paraqitjes se çdo lloj dokumentacioni të kërkuar nga Komisioni në lidhje me automjetin objekt shqyrtimi, duke mos bërë asnjë përpjekje për të hequr dyshimet. Për rrjedhojë, referuar edhe faktit, që në mënyrë të përsëritur subjekti përdor automjete që *de jure* nuk janë në pronësi të tij, Komisioni çmoi këtë qëndrim në vlerësimin tërësor të çështjes, si shkak për penalizmi të subjektit të rivlerësimit, në konsideratë edhe të parashikimit të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

Në lidhje me deklaratimet e kursimeve *cash*:

⁵⁵Shihni pyetjen nr. 7 të pyetësorit nr. 2 në dosjen e Komisionit.

⁵⁶Shihni arsyetimin në paragrafin 36 të këtij vendimi.

⁵⁷Shihni arsyetimin në paragrafin 30 të këtij vendimi.

83. Nga verifikimi i DPV-ve, ndër vite, janë evidentuar këto deklaramë të kryera nga subjekti: (i) në DPV/2007 gjendje *cash* në shumën 400.000 lekë; (ii) në DPV/2009 kursime të mbetura nga paga në shumën 300.000 lekë; (iii) në DPV/2010 kursime të mbetura nga paganë shumën 200.000 lekë; (iv) në DPV/2015 kursim nga paga, gjendje *cash* në shumën 400.000 lekë; (v) në DPV/2016 gjendje *cash* në shumën 400.000 lekë; (vi) subjekti nuk ka deklaruar në asnjë DPV pakësime të gjendjes *cash*, përveç se në DPV/2016⁵⁸.

Për shkak të mos specifikimit në deklaramë nëse këto shuma ishin gjendje apo shtesa, u pyet subjekti për të saktësuar se çfarë përfaqësonin shumat *cash* të deklaruara prej tij dhe nga sqarimet e dhëna⁵⁹ u konkludua se këto shuma janë gjendje *cash* në fund të çdo viti dhe jo shtesa të tij. Në të njëjtën linjë është deklarimi i subjektit në lidhje me gjendjen *cash* edhe në deklaramët në ILDKPKI⁶⁰. Bazuar në të gjitha më sipër, duket se deklaramët e gjendjes *cash* janë konsistente, duke shtuar këtu edhe faktin se subjekti vjen në deklaratën *Vetting* me gjendje *cash* në shumën 400.000 lekë, e cila është e njëjtë me shumën e dekluarur në datën 31.12.2016, Komisioni ka konsideruar në analizën financiare shumat e deklaruara nga subjekti si gjendje *cash* në fund të çdo viti dhe jo shtesa.

Në lidhje me të ardhura nga bujqësia:

84. Në deklaratën *Vetting*, secili nga prindërit e subjektit ka deklaruar: “*Të ardhura nga veprimtaria private, përfitim i produkteve bujqësore të përlllogaritura mesatarisht në shumën 100.000 leke/vit*”, shumën 500.000 lekë për periudhën 2007 – 2016, por nuk kanë bashkëlidhur asnjë dokument shkresor që vërteton këto të ardhura.

Me qëllim përfshirjen ose jo të këtyre të ardhurave në analizën financiare, iu kërkua subjektit të paraqesë dokumente shkresorë që vërtetojnë të ardhura të ligjshme nga toka bujqësore në shumën e dekluarur. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka sqaruar se për shkak të produkteve të prodhuara nga sipërfaqja e tokës bujqësore që disponon babai, janë ulur shpenzimet e shportës ushqimore të familjes së tij. Kjo e ardhur është mesatarisht në vit rreth 100.000 lekë në vit, shumë e cila nuk është në formën e të hollave nga shitja e produkteve por në natyrë dhe se këto produkte ushqimore konsumohen nga familja e subjektit. Ndërsa sa i takon dokumentacionit të kërkuar, subjekti ka deklaruar se prindërit nuk janë të regjistruar si fermerë dhe as të siguruar si të vetëpunësuar në bujqësi, por ka paraqitur si provë⁶¹ një vërtetim të Bashkisë Lushnjë, nëpërmjet të cilit kërkon të provojë se është paguar taksa për tokën e gjyshit të tij, pjesë nga e cila ka trashëguar edhe babai i subjektit A. T..

Në analizën financiare dërguar me rezultatet e hetimit administrativ, në të ardhurat e familjes së origjinës së subjektit, nuk janë përfshirë të ardhura nga toka bujqësore, si dhe nuk janë bërë reduktime të shpenzimeve të jetesës, referuar fakteve si vijojnë: (i) vërtetimet mbi pagesën e taksës së tokës së gjyshit të subjektit H. T., nuk janë të mjaftueshme për të provuar se ka pasur prodhime bujqësore nga kjo tokë; (ii) prindërit e subjektit nuk jetojnë në fshatin ku ndodhet toka, pra, objektivisht nuk kanë pasur mundësi ta punojnë atë; (iii) për shkak se subjekti ka

⁵⁸Në DPV/2016 subjekti, kur deklaroi blerjen e automjetit në shumën 600.000 lekë, ka përcaktuar burimin si “*kursime nga paga e vitit 2015 dhe 2016*” dhe meqenëse në vitin 2015 ka deklaruar kursime *cash* nga paga në shumën 400.000 lekë, kjo shumë *cash* do t’i konsiderohet si e përdorur dhe e rikrijuar gjatë vitit 2016.

⁵⁹Shihni pyetësorin nr. 2, datë 23.9.2021.

⁶⁰Shihni procesverbalin, datë 26.9.2014, të mbajtur në ILDKPKI, ku i pyetur për gjendjen e likuiditeteve *cash* në datën 31.12.2013, subjekti ka deklaruar “*Likuiditeti cash në fund të vitit 2013 dhe aktualisht është 0 (zero)*”, deklarim i cili përputhet me DPV/2013.

⁶¹Vërtetimi nr. ***, datë 24.10.2016 nga Bashkia Lushnjë mbi pagesën e taksës së tokës bujqësore për vitet 2011 – 2015, ndodhur në Aneksin 4/11, në dosjen ILDKPKI-së, është administruar më parë nga Komisioni.

bashkëjetuar me prindërit e tij, sipas ligjit duhet të kishte deklaruar të ardhura nga toka bujqësore në DPV-të. ndër vite, gjë të cilën nuk e ka bërë.

85. Në parashtrimet e tij, subjekti ka deklaruar se babai trashëgon nga i ati, gjyshi subjektit H. T., 6.000 m² tokë arë, e cila është kultivuar nga viti 1994, duke prodhuar kështu produkte ushqimore. Për këtë arsye, subjekti kërkon që të reduktohen shpenzimet e jetesës me shumën 100.000 lekë/vit, të cilat përfaqësojnë të ardhurat në natyrë të përfituara nga toka bujqësore, sikurse ato janë deklaruar nga babai i subjektit në deklaratën *Vetting*, shumë e cila është më e vogël se përqindja që zë shporta e produkteve ushqimore në totalin e shpenzimeve të jetesës. Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti ka paraqitur disa dokumente shkresore⁶². Po kështu, subjekti ka sjellë në vëmendje të Komisionit 5 vendime të Komisionit të formës së prerë, në të cilat janë marrë në konsideratë të ardhura nga toka bujqësore, si dhe është pranuar se shpenzimet e jetesës së këtyre familjeve, për shkak të ekonomisë bujqësore janë më të ulëta. Subjekti kërkon që Komisioni të mbajë të nijetin qëndrim edhe në rastin e tij.

86. Duke pasur në konsideratë të gjitha rastet e referuara nga subjekti dhe në analizë të sqarimeve dhe dokumenteve të paraqitura prej tij, në procesin e vlerësimit përfundimtar Komisioni çmoi se, të ardhurat nga toka bujqësore të informuara nga Bashkia Lushnjë, nuk janë reale por thjesht indikative dhe të bazuara në të dhëna statistikore. Por, duke marrë në konsideratë faktet dhe rrethanat si vijojnë: (i) babai i subjektit ka në pronësi tokë arë të trashëguar nga babai; (ii) janë paguar taksat e tokës bujqësore; (iii) fshati ku ndodhet toka është shumë afër banesës së prindërve të subjektit; (iv) shifra e të ardhurave nga toka deklaruar në deklaratën *Vetting* është e logjikshme⁶³, Komisioni çmoi që të pranojë pretendimin e subjektit se prindërit kanë kultivuar produkte bujqësore për të mbuluar një pjesë të produkteve ushqimore dhe, për këtë arsye, vendosi të reduktojë shpenzimet e jetesës me shumën 500.000 lekë, për periudhën 2007 – 2016 (10-vjeçare) ose 50.000 lekë/vit. Ky reduktim është bërë edhe për periudhën 1994 – 2006, para detyrës së subjektit. Për shkak të marrjes në konsideratë të këtij pretendimi, ka ndryshuar rezultati financiar për të gjitha vitet e periudhës së rivlerësimit, i cili pasqyrohet në tabelën përmbledhëse në paragrafin 91 të këtij vendimi.

Në lidhje me shpenzime mobilimi:

87. Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti është shprehur në lidhje me mobilimin e kryer, si dhe orenditë shtëpiake në banesën në O., Vlorë, në një shumë prej 70.000 lekë, të cilat janë realizuar në periudha të ndryshme kohore. Ndërsa, në procesverbalin e mbajtur në datën 26.11.2014, në ILDKPKI, i pyetur mbi shpenzimet për mobilimin e apartamentit në O., subjekti deklaroi: “*Vlera totale e shpenzimeve nuk e kalon vlerën prej 300.000 lekësh, shpenzime të bëra në mënyrë periodike.*” I pyetur në lidhje me këtë mospërputhje dhe se cili ka qenë shpenzimi real dhe periudhat e kryerjes se çdo shpenzimi, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti nuk ka kryer sqarime në lidhje me mospërputhjen, ndërsa ka konfirmuar se këto shpenzime janë kryer në periudha të ndryshme dhe se nuk e kalojnë shumën 300.000 lekë.

⁶²Shihni dokumentet e paraqitura nga subjekti me parashtrimet e tij dhe konkretisht shkresën nr. *** prot., datë 15.9.2021, lëshuar nga Sektori i Vlerësimit dhe Regjistrimit pranë Drejtorisë së të Ardhurave Vendore, Bashkia Lushnje, e cila informon se shtetasi H. T. (gjyshi i subjektit ka vdekur në janar të vitit 1993) nuk ka detyrime në këtë drejtori; shkresë kthim përgjigje⁶² nr. *** prot., datë 28.10.2021, lëshuar nga Agjencia Rajonale e Eskensionit Bujqësor Lushnjë, e cila informon mbi të ardhurat dhe shpenzimet për disa kultura bujqësore për periudhën 1993 – 2016. Nga përmbajtja e kësaj shkrese konstatohet se të dhënat janë përlogaritur në bazë të treguesve statistikorë në vite, të mesatarizuara për 1 ha të mbjellë me kulturat e informuara nga subjekti; plan rievimi, datë 29.10.2021, hartuar nga ing. A. K., që informon se toka në pronësi të shtetasit H. T. është 2 km larg nga banesa e prindërve të subjektit.

⁶³Babai i subjektit ka deklaruar të ardhura nga toka bujqësore në shumën 500.000 lekë, për periudhën 2007 – 2016.

- Konsiderimin e vlerës së apartamentit në Vlorë, në shumën 24.000 euro dhe jo 27.000 euro, duke hequr si shpenzim shumën 3.000 euro të shpërndarë në mënyrë të barabartë në vitet 2010 deri 2012, pretendim i cili nuk është marrë parasysh, sikurse është trajtuar në paragrafin 26 të këtij vendimi.

- Njohjen si burim të shumës *cash* prej 400.000 lekësh të deklaruar në DPFD në vitin 2007, si e përdorur për pagimin e shumës 4.000 euro për blerjen e pasurisë në O. në tetor të vitit 2008, pretendim i cili nuk është marrë parasysh, sikurse është trajtuar në paragrafin 33 të këtij vendimi.

- Përfshirjen si pasuri të automjetit tip “Mercedes-Benz”, në shumën 600.000 lekë, të blerë në vitin 2016 dhe jo në vlerën 13.000 euro në vitin 2012, pretendim i cili është marrë parasysh, sikurse është trajtuar në paragrafin 54 të këtij vendimi.

- Përfshirjen si të ardhur të ligjshme në vitin 2008, të shumës 300.000 lekë të përfituar nga shitja e automjetit tip “Nissan Primera” (në vend të shumës 200.000 lekë), pretendim i cili nuk është marrë parasysh, sikurse është trajtuar në paragrafin 60 të këtij vendimi.

- Përfshirjen si të ardhur të ligjshme të huas në shumën 1.800.000 lekë, marrë nga vëllai i tij në vitin 2011, pretendim i cili nuk është marrë parasysh, sikurse është trajtuar në paragrafët 35-37 të këtij vendimi.

- Rishikimin e shpenzimeve të jetesës, për të gjithë periudhën e rivlerësimit, për shkak të përdorimit të produkteve nga toka bujqësore e prindërve të subjektit, duke i reduktuar ato në shumën 100.000 lekë/vit. Vetëm për vitin 2007, përveç këtij reduktimi, subjekti ka kërkuar të përfshihet si e ardhur edhe shuma 100.000 lekë. Këto pretendime të subjektit janë marrë parasysh pjesërisht dhe shuma prej 500.000 lekësh për të gjithë periudhën e rivlerësimit ose 50.000 lekë/vit⁶⁷, sikurse është deklaruar nga babai i subjektit në deklaratën *Vetting* është reduktuar nga shpenzimet e jetesës së subjektit dhe familjes së tij, sikurse është trajtuar në paragrafin 86 të këtij vendimi.

- Rishikimin e shpenzimeve të jetesës në disa zëra të strukturës së tyre, duke i reduktuar ato nga shpenzimet e jetesës të përlllogaritura nga Komisioni, sipas përqindjeve që zë secili prej këtyre zërave në strukturën e shpenzimeve të jetesës, sipas Anketës së Buxhetit të Familjes, kryer nga INSTAT, të vitit përkatës. Konkretisht subjekti kërkon:

- a) shpenzimet e udhëtimeve të reduktohen në masën 3.2% - 5%;
- b) shpenzimet e transportit, të reduktohen në masën 5.7%-6.3%;
- c) shpenzimet e mobilimit, të reduktohen në masën 5.9%;
- ç) shpenzimet e qirasë, për vitet 2009 – 2011, të reduktohen në masën 7.4%.

Sa i takon këtij pretendimi, Komisioni arsyeton se shpenzimet e jetesës sipas standardit të ILDKPKI-së dhe INSTAT-it, kanë për qëllim të standardizojnë dhe unifikojnë këto shpenzime për të gjithë shtetasit shqiptarë. Këto shpenzime janë të mesatarizuara dhe përfshijnë të gjitha shtresat e popullsisë dhe zonat e Shqipërisë, çka do të thotë se ato nuk mund të përfaqësojnë shpenzimet reale të çdo individi dhe familjeje. Në këtë kuptim, ato përbëjnë një vlerë mesatare që përfaqëson një jetesë normale (mbi minimumin jetik) të një familjeje dhe jo shpenzime që

⁶⁷Në deklaratën *Vetting*, babai i subjektit ka deklaruar të ardhura në shumën 100.000 lekë/vit, ndërsa për vitet 2007– 2016, ka deklaruar një total prej 500.000 lekësh ose 50.000 lekë/vit.

realisht janë kryer nga subjekti dhe familja e tij. Shpenzimet e jetesës sipas standardit të ILDKPKI-së dhe INSTAT-it përdoren nga Komisioni, në mungesë të të dhënave të dokumentuara të subjekteve të rivlerësimit. Në rastin e subjektit të rivlerësimit Ervin Trashi, Komisioni ka të dhëna të evidentuara për shpenzimet e qirasë, udhëtimeve nga sistemi TIMS, transportit dhe mobilimit dhe, për këtë arsye, ka përdorur këto të dhëna për llogaritjen e shpenzimeve në analizën financiare. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit nuk janë marrë në konsideratë.

91. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, pasi janë marrë në konsideratë disa nga pretendimet e subjektit, trajtuar në mënyrë të detajuar në këtë vendim, rezultati financiar përfundimtar për të gjithë periudhën e rivlerësimit është përmirësuar nga -7.726.668 lekë në -5.963.356 lekë.

0	1	2	3	4	5	6
Vitet	Pasuri	Detyrime	Pasuri neto (1-2)	Të ardhura	Shpenzime	Mundësia për kursime (4-5-3)
2 007	825 083	-	825 083	281 195	85 883	-629 771
2 008	4 751 871	2 447 126	2 304 745	1 246 304	589 895	-1 648 336
2 009	429 504	-112 194	541 698	1 333 590	899 374	-107 481
2 010	267 428	-550 545	817 973	1 305 335	802 824	-315 463
2 011	-1 827	-2 466 511	2 464 684	1 154 894	968 950	-2 278 741
2 012	337 748	-400 000	737 748	1 272 074	933 336	-399 010
2 013	-191 833	-400 000	208 167	1 251 515	756 499	286 850
2 014	-47 600	-400 000	352 400	1 483 962	840 511	291 052
2 015	372 898	-300 000	672 898	1 500 295	978 903	-151 506
2 016	1 596 782	-	1 596 782	2 120 754	957 020	-433 048

Metodologjia e përdorur për analizën financiare

92. Në analizën financiare, për çdo pasuri të krijuar dhe/ose shpenzim të kryer, është analizuar mundësia financiare e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, duke krahasuar në çdo rast informacionet e marra në rrugë zyrtare nga institucionet kompetente ligjore me deklaratimet e subjektit. Kjo analizë është kryer duke marrë në konsideratë:

92.1 Të ardhurat

Subjekti është analizuar së bashku me prindërit e tij, për të gjithë periudhën e rivlerësimit 5.10.2007 – 31.12.2016 dhe, për rrjedhojë, në analizën financiare janë konsideruar të ardhurat e dokumentuara të:

- subjektit: bursë nga Shkolla e Magjistraturës⁶⁸ dhe pagat duke filluar nga data e emërimit në detyrë⁶⁹;

⁶⁸Vërtetim nr.***, datë 26.10.2016, nga Shkolla e Magjistraturës.

⁶⁹Vërtetim nr.***, datë 12.10.2016, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, për periudhën e punësimit nga 1.4.2009 – 14.11.2011; vërtetim nr.***, datë 19.1.2017, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, për periudhën e punësimit 5.10.2007–1.4.2009 dhe 15.11.2011 deri sot.

- të ardhurat e nënës⁷⁰ dhe babait⁷¹ të subjektit, nga punësimi dhe pensioni i tyre;
- të ardhura nga bono privatizimi të paguara në datën 11.6.2010, në “Credins Bank”; si dhe
- të ardhura të akumuluar nga kursimet e prindërve, të cilat janë llogaritur veçmas subjektit, duke konsideruar vetëm të ardhurat dhe shpenzimet e tyre. Për shkak se prindërit e subjektit nuk kanë qenë subjekte deklarues, kursimet e tyre vjetore nuk kanë qenë detyrim deklarimi i subjektit dhe, për këtë arsye, tepricat pozitive të çdo viti, duke filluar nga viti 2009⁷², janë konsideruar si e ardhur, e cila ka shërbyer si pjesë për krijimin e kursimeve të tyre në vlera monetare të deklaruara në deklaratën *Vetting*.

92.2 Shpenzimet

- Shpenzimet e udhëtimit janë bazuar në raportin e sistemit *TIMS* dhe sqarimeve të dhëna nga subjekti gjatë procesit të hetimit administrativ. Metodologjia e përlllogaritjes së këtyre shpenzimeve është ajo e përcaktuar në vendimin (JR) nr. 11, datë 22.5.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.
- Shpenzimet e transportit nga banesa në vendin e punës janë përlllogaritur duke konsideruar çmimin e biletës 700 lekë për transportin publik Lushnjë-Vlorë-Lushnjë; ditët e punës së një muaji 22 dhe muajt e punës 11 (pa gushtin), si dhe bazuar në periudhat që subjekti ka punuar në Vlorë dhe konkretisht: 5.10.2007 – 31.3.2011 dhe 15.11.2010 – 31.12.2016.
- Për kohën e qëndrimit në Gjirokastrë nga 1.4.2009 – 14.11.2011, janë përfshirë shpenzime qiraje sipas deklarimeve të subjektit.
- Janë përfshirë si shpenzime interesat dhe çdo shpenzim i lidhur me kredinë bankare në NBG.
- Shpenzimet e mobilimit janë konsideruar sipas deklarimeve të subjektit në procesverbalin mbajtur në ILDKPKI, në datën 26.9.2014.
- Është përfshirë çdo shpenzim i evidentuar gjatë hetimit administrativ, si dhe dokumente të administruara në dosjen e Komisionit dhe ILDKPKI-së.

92.3 Pasuritë

- Është përfshirë makina e blerë nga subjekti në vitin 2007, me vlerën bazuar në kontratën e shitjes.
- Në analizën financiare të subjektit është përfshirë kostoja e katit të tretë, duke konsideruar se është ndërtuar për periudhën 14.4.2007 – dhjetorit 2008. Vlera e investimit të katit është përlllogaritur bazuar në çmimet e EKB-së për metër katror për sipërfaqe ndërtimi, në qytetin e Lushnjës, për vitet 2007 dhe 2008. Nga kjo vlerë është veçuar dhe përfshirë në analizën e subjektit pjesa proporcionale pas datës 5.10.2007, kur subjekti është emëruar në detyrë dhe deri në dhjetor të vitit 2008.
- Blerja e parcelës ndërtimore nga babai i subjektit në vitin 2010 me të ardhura të familjes.
- Blerja e apartamentit në O., në vlerën 24.000 euro, në vitin 2008. Është përfshirë si investim mbi këtë vlerë, shuma 3.000 euro e shpenzuar nga subjekti për riparime në apartament, e cila është ndarë në mënyrë të barabartë për vitet 2010 – 2012.
- Likuiditetet janë trajtuar si pjesë e pasurive në një zë të veçantë. Këtu janë përfshirë gjendjet e llogarive bankare⁷³ të subjektit dhe prindërve në fund të çdo viti/date të analizuar dhe gjendjet

⁷⁰Vërtetim mbi bazën e vlerësueshme nga ISSH-së Lushnjë për punësimin në Drejtorinë Rajonale Arsimore Lushnjë për periudhën 1994 – 5.2014; vërtetim nr. ***, datë 10.1.2017, nga ISSH-ja për pensionin e shtetasës Sh. T. nga 05/2014– 12/2016.

⁷¹Vërtetim nga Stacioni Hekurudhor Lushnjë për periudhën e punësimit nga 10/2007 – 11/2009; vërtetim nr. ***, datë 10.1.2017, nga ISSH-ja për pensionin e shtetasit A. T., për periudhën 03/2011– 12/2016.

⁷²Kursimet e prindërve për vitet 2007 dhe 2008, janë konsideruar të shpenzuara për ndërtimin e katit të tretë të banesës në Lushnjë.

⁷³Shkresat nr. *** prot., datë 6.5.2020 nga “Raiffeisen Bank”; nr. *** prot., datë 30.4.2020, nga “ABI Bank”; nr. *** prot., datë 6.5.2020, nga “Tirana Bank”.

cash, sikurse janë deklaruar nga subjekti në DPV-të dhe sqarimet e dhëna gjatë procesit të rivlerësimit.

- Ndryshimi i likuiditeteve, pakësimi ose shtesa nga viti në vit, është pasuria e krijuar nga subjekti për çdo vit.

- Shuma e pasurive dhe likuiditeteve, përbën totalin e pasurisë së akumuluar nga subjekti, nga fillimi i detyrës deri në fund të periudhës së vlerësimit.

92.4. Detyrimet

- Është përfshirë kredia e marrë nga NBG (sot ABI Bank) në vitin 2008 dhe shlyerja e saj.

- Nuk është përfshirë huaja e marrë nga vëllai në vitin 2011, ndërsa shlyerja e saj është përfshirë.

Rezultati financiar është i përlogaritur për çdo vit, për çdo datë/periudhë të krijimit të pasurisë/ve, si dhe në total. Mundësia për kursime rezulton si shumatore e të ardhura – (shpenzime + pasuri neto), për çdo vit dhe për të gjithë periudhën e rivlerësimit.

Vlerësimi përfundimtar në lidhje me kriterin pasuror

93. Në përfundim të procesit të rivlerësimit të kriterit të pasurisë u vërtetua se subjekti i rivlerësimit Ervin Trashi:

i) ka kryer deklarime të pasakta dhe që vijnë në kundërshtim me ligjin (germa “a”, e pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016), si në deklaratat e interesave periodike verorë ashtu edhe në deklaratën *Vetting*;

ii) ka mungesë të burimesh të ligjshme financiare për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet gjatë gjithë periudhës së rivlerësimit, për shkak balancës negative në shumën 5.993.356 lekë (germa “d”, e pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016).

Kontrolli i figurës

94. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/206. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin nr. *** prot., datë 2.11.2017, mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Ervin A. Trashi, i deklasifikuar pjesërisht me vendim nr. ***, datë 8.10.2021, të KDZH-së, nga ku, midis të tjerash rezulton se bazuar në parashikimet e bëra në Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin DH “kontrolli i figurës”, pika 4, subjekti i rivlerësimit Ervin A. Trashi, ka pasaktësi në plotësimin e deklaratës për kontrollin e figurës, duke mos deklaruar procedimin penal të regjistruar në ngarkim të tij për veprën penale “korrupsion aktiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë”, parashikuar nga nenet 319 e 319/ç të Kodit Penal. Në përfundim, referuar këtij fakti, si dhe disa të dhënave të tjera që kanë lidhje me figurën e subjektit të rivlerësimit, grupi i punës së DSIK-së konstaton papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Ervin A. Trashi.

Hetimi i Komisionit

95. Gjatë hetimit administrativ Komisioni verifikoi formularin për kontrollin e figurës, sipas shtojcës nr. 3 të ligjit nr. 84/2016, në të cilin rezultoi se pyetjes “A jeni përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar” subjekti i është përgjigjur me jo.

Në nenin 3, pika 15, të ligjit nr. 84/2016 përcaktohet se *“Person i përfshirë në krimin e organizuar është çdo person që është dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009, ‘Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë’, të ndryshuar, me përjashtim të rastit kur është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë. Personi konsiderohet i përfshirë në krimin e organizuar edhe kur: (a) procedimi penal i filluar ndaj tij pushohet nga organi procedues për shkak të vdekjes, ose sepse nuk mund të merret si i pandehur dhe nuk mund të dënohet; (b) deklarohet i pafajshëm nga gjykata pasi vepra penale është kryer nga një person, që nuk mund të akuzohet ose dënohet.*

96. Nisur nga informacioni i paraqitur në raportin e DSIK-së, me qëllim evidentimin e faktit nëse ndaj subjektit ka pasur të regjistruar një procedim penal, me kërkesë të Komisionit, SPAK⁷⁴ informoi se në datën 24.9.2015 është regjistruar procedimi penal nr. ***, në ngarkim të shtetasit Ervin Trashi, për veprat penale të parashikuara nga nenet 319 dhe 319/ç të Kodit Penal, pushuar me vendimin e datës 21.3.2016, vepra të cilat bëjnë pjesë në pikën 1, të nenit 3, të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, *“Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”*.

97. Bazuar në sa më sipër, subjekti nuk ka plotësuar me vërtetësi deklaratën e kontrollit të figurës, sipas shtojcës nr. 3 të ligjit nr. 84/2016. I pyetur gjatë procesit të rivlerësimit lidhur me këtë fakt, subjekti duke dhënë sqarime të detajuara, duke pretenduar se në formularin për kontrollin e figurës është përgjigjur në mënyrë korrekte, pasi sipas tij asnjëherë nuk ka qenë i përfshirë në veprimtari që lidhen me krimin e organizuar dhe se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka vendosur të pushohen hetimet e procedimit penal nr. ***, pasi nuk ka rezultuar asnjë provë që prej tij të jenë konsumuar elementët e ndonjë vepre penale⁷⁵.

98. Pavarësisht deklarimeve të subjektit, ligji nr. 84/2016 në nenin 3 të tij, parashikon se personi do të konsiderohet i përfshirë në krimin e organizuar edhe në rastin kur procedimi penal i filluar ndaj tij pushohet nga organi procedues, me përjashtim të rastit kur është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë. Për rrjedhojë, subjekti nuk ka plotësuar në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi deklaratën për kontrollin e figurës sipas pikës 4, të nenit DH ,të Aneksit të Kushtetutës dhe shtojcës nr. 3, të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk ka deklaruar procedimin penal të regjistruar në ngarkim të tij për veprën penale *“korrupsion pasiv i gjyqtarit, prokurorit dhe i funksionarëve të tjerë të drejtësisë”*, parashikuar nga neni 319/ç i Kodit Penal, vepër penale e cila përfshihet në pikën 1, të nenit 3, të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, *“Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”*. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i është kërkuar të japë sqarime në lidhje me këtë konstatim.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit mbi bazën e fakteve dhe ligjit të zbatueshëm

99. Në parashtrimet e datës 5.11.2021, subjekti ka mbajtur të njëjtin qëndrim me deklaratimet gjatë procesit të rivlerësimit duke dhënë sqarime të detajuara dhe duke bërë interpretimin e tij për pikën 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016. Në vijim të parashtrimeve të tij, subjekti pretendon se informacioni i dhënë nga SPAK është i cunguar, pasi pavarësisht se në shkresën kthim

⁷⁴Shihni shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 8.10.2021, nga SPAK në dosjen e Komisionit.

⁷⁵Shihni përgjigjet e subjektit dërguar në rrugë elektronike në datën 14.10.2021, në dosjen e Komisionit.

përgjigjeje, ky institucion vë në dijeni organet e rivlerësimit për regjistrimin dhe pushimin e procedimit penal, bashkëngjitur shkresës ka vendosur vetëm vendimin e regjistrimit të procedimit penal dhe jo vendimin e pushimit të procedimit penal. Gjithashtu, për të kundërshtuar raportin DSIK-së, subjekti i kërkon Komisionit të mbajë parasysh se në rastin konkret është regjistruar në mënyrë të paligjshme një procedim penal ndaj tij, pasi Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë nuk ka pasur kompetencë lëndore për regjistrimin e procedimit penal, duke qenë se kompetenca lëndore i përkiste Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda Tiranë.

Për të mbështetur pretendimit e tij, subjekti paraqiti vendimin e pushimit të procedimit penal nr. ***, datë 2103.2016, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë dhe urdhër për regjistrimin e veprës penale dhe të emrit të personit që i atribuohet vepra penale, ndaj shtetasit Ervin Trashi, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

100. Nga analiza e sqarimeve dhe dokumenteve të paraqitura konstatohet se subjekti nuk ka provuar të kundërtën e barrës së provës, pasi nuk ka paraqitur asnjë argument të ri për të kundërshtuar konstatimin e Komisionit se në kuptim të pikës 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, konsiderohet person i përfshirë në krimin e organizuar dhe nuk provoi të ishte deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë. Në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, pavarësisht faktit se sipas vendimit të pushimit të procedimit penal, gjatë hetimit të çështjes ka nuk rezultuar asnjë provë që prej subjektit të jenë konsumuar elementët e ndonjë vepre penale, Komisioni vlerësoi se, subjekti ka pasur detyrimin ta deklaronte këtë fakt në formularin për kontrollin e figurës, sipas shtojcës nr. 3 të ligjit nr. 84/2016. Sipas parashikimit të pikës 4, të nenit DH, Aneksit të Kushtetues, nëse subjektet kanë kryer deklarime të pasakta, zbatohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, fakt që e penalizon subjektin Ervin Trashi dhe përben një shkak për shkarkimin e tij nga detyra së bashku me pamjaftueshmërinë në deklarime në lidhje me kriterin pasuror, sipas nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016.

IV. SEANCA DËGJIMORE

Në datën 9.11.2021, sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, u zhvillua seanca dëgjimore për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Ervin Trashi. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin e tij, duke dhënë sqarime të mëtejshme mbi rezultatet e hetimit administrativ, procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, si dhe duke iu përgjigjur pyetjeve të drejtuara nga anëtarët e trupit gjykues, duke kërkuar riçeljen e hetimit edhe për vlerësimin e aftësive profesionale. Në datën 12.11.2021, u zhvillua seanca, në të cilën Komisioni shpalli vendimin për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Ervin Trashi.

V. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Gjatë procesit të rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme, trupi gjykues ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016. Në komunikimet e tij, subjekti Ervin Trashi përgjithësisht ka bashkëpunuar me Komisionin dhe ka qenë i gatshëm në kthimin e përgjigjeve, por janë evidentuar raste kur ka munguar të japë përgjigje dhe dokumente shkresore në lidhje me konstatime të Komisionit, ndërkohe që, në përpjekje të argumentimit të mosveprimeve të tij, ka mbajtur qëndrime të paqarta dhe kontradiktore me deklarime të tij apo fakte të rezultuara nga hetimi administrativ.

VI. KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, gjatë bisedimeve për vlerësimin përfundimtar të çështjes, bazuar në provat e administruara gjatë procesit të rivlerësimit, si dhe në qëndrimin e subjektit të rivlerësimit për çdo çështje, rast pas rasti, arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit Ervin Trashi, nuk arin nivelin kualifikues, pasi ka kryer deklarime të pasakta dhe të pamjaftueshme, për sa i takon kriterit të kontrollit të pasurisë dhe figurës, sipas nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016, çka përbën shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Vendimmarrja për këtë subjekt u vlerësua të bazohet vetëm në përfundimet e arritura në lidhje me kriterin e pasurisë dhe të figurës dhe në vlerësimin tërësor të rrethanave sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, sipas parashikimit të pikës 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, bazuar në germën “c”, të pikës 1, të nenit 58 dhe në pikën 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Ervin Trashi, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore 64 dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 12.11.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Brunilda BEKTESHI
Kryesuese

Firdes SHULI
Relatore

Suela ZHEGU
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Orjanda Liçi